



Empowered lives.  
Resilient nations.

## RAPORTI

# RAPORT MBI GJETJET KRYESORE NGA MONITORIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË, ME OBJEKT ZGJIDHJEN E MARTESËS DHE RREGULLIMIN E PASOJAVE TË SAJ

PERIUDHA E MONITORIMIT: JANAR-DHJETOR 2014

Përgatitja e këtij raporti u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Qeveria e Suedisë. Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e UNDP-së apo të Qeverisë Suedeze.

Tiranë, 2015

Ky raport është hartuar në bazë të gjetjeve nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, në lidhje me pensionet ushqimore për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, nga monitorimi i praktikave të Zyrës së Përmbarimit, Tiranë, për ekzekutimin e këtyre vendimeve, si dhe të praktikës së Qendrës për Nisma ligjore Qytetare për përfaqësimin ligjor në këto raste.

Raporti u realizua në kuadër të zbatimit të projektit: “Çështjet strategjike për mbrojtjen e të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe të grave në rastet me objekt zgjidhje martesë”, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe fonde të Qeverisë Suedeze.

C: QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

Rr. Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë, Shqipëri, website: [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)

**Përgatitën:** Prof.Dr. Av. Aurela Anastasi, Av. Aurela Bozo, Dr. Av. Evis Garunja.

**Grupi i punës** për monitorimin e vendimeve gjyqësore:

Av. Iris Aliaj

Eda Gjoka

Inklida Allka

Saimira Kopani

Oltion Musaj

**Design:** Elvis Bejtja

# Përmbajtja

<b>Metodologjia</b> .....	5
<b>1. Kuadri Ligjor në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijët</b> .....	7
<b>2. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore</b> .....	15
<b>2.1.</b> Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e martesës dhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët.....	15
<b>2.1.1.</b> Profili i palëve në çështjet me objekt “zgjidhje martese dhe caktimi i detyrimit ushqimor për fëmijët”; .....	15
<b>2.1.2.</b> Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “zgjidhjen e martesës dhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët”; .	20
<b>2.2.</b> Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën/t”; .....	29
<b>2.2.1.</b> Profili i palëve në çështjet me objekt “kërkimin e detyrimit ushqimor për fëmijët”; .....	29
<b>2.2.2.</b> Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën/t”; .....	34
<b>2.3.</b> Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor”; .....	40
<b>2.3.1</b> Profili i palëve në çështjet me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor”; .....	40
<b>2.3.2.</b> Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “ndryshimi i vendimit për masën e detyrimit ushqimor për fëmijën/t.....	46
<b>2.4.</b> Konkluzione dhe Rekomandime.....	59
<b>3. Analiza e një rasti konkret</b> .....	61
<b>4. Çështje të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve në rastet e zgjidhjes së martesës.</b> .....	64
<b>5 Bibliografia:</b> .....	74



## Metodologjia

Për realizimin e këtij raporti është shfrytëzuar informacioni i mbledhur nga analiza e 655 vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Zgjidhje e martesës» dhe rregullimin e pasojave të saj, të përfuar gjatë monitorimit të faqes zyrtare të web-it të kësaj gjykate. Pjesë e monitorimit kanë qenë edhe gjetjet e evidentuara nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare nga Zyra e Përmbartimit mbi çështjet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor në favor të fëmijëve në rastet e zgjidhjeve të martesës.

Raporti është përqendruar në periudhën kohore një vjeçare, konkretisht gjatë vitit 2014, mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë me objekt “Zgjidhje martesë”, “Kërkimi i detyrimit ushqimor”, “Ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor”, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çështjet për Ekzekutim të ndërmarra nga Zyra e Përmbartimit, Tiranë, vendime të cilat kanë në qendër të tyre detyrimin ushqimor të prindit debitor ndaj fëmijës së mitur në respektim të interesit më të lartë të fëmijës.

Duke patur si qëllim të ofrojmë një raportim sa më real të situatës konkrete, nga pikëpamja statistikore jemi përpjekur të evidentojmë të gjithë ato vendime gjyqësore të cilat kanë në objektin e tyre marrëdhëniet familjare me fokus detyrimit ushqimor për fëmijët e mitur, mbi bazën e një analize të hollësishme të secilit vendim të formës së prerë të dhënë nga Gjykata e Tiranës. Këto vendime gjyqësore janë seleksionuar duke u bazuar në ndarjen e bërë në website-n e Gjykatës së Tiranës në seksionin e çështjeve familjare.

Nxjerrja e të dhënave nga secili vendim, pjesë e monitorimit, është bërë duke u mbështetur në skedën e realizuar paraprakisht e cila listonte të dhënat mbi palët në gjykim, gjeneralitetet dhe statusin e tyre social, ekonomik, arsimor; evidentonte marrëdhënien e palëve me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor, përfaqësimin me avokat, pretendimet e palëve gjatë procesit dhe tërësinë e provave të paraqitura, qëndrimin e gjykatës dhe arsyet mbështetëse të këtij gjykimi, si dhe të tjera elemente përbërëse që lidhen me arsyet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga Zyra e Përmbartimit.

Të dhënat e mbledhura shërbyen për të konceptuar tabelat përkatëse dhe për të ndërtuar grafikët e nevojshëm për pasqyrimin praktik të gjetjeve të reja që lidhen me situatën e vendimeve gjyqësore mbi caktimin apo ndryshimin e detyrimit ushqimor ose ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore.

Në këtë raport disa nga gjetjet më të spikatura nga vendimet gjyqësore të monitoruara janë bërë pjesë e ilustrimeve dhe shpjegimeve të rezultateve të dalta nga skeda e vlerësimit.

Konkretisht, janë monitoruar 655 vendime gjyqësore të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt Zgjidhje martesë nga të cilët në 505 vendime kemi një shprehje të gjykatës me vendim të formës së prerë për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin ligjor të pasojave të saj. Pjesë e monitorimit kanë qenë edhe 33 vendimet gjyqësore me objekt “Kërkimin e detyrimit ushqimor”, nga të cilat në 19 prej tyre gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë mbi kërkesën e paraqitur. Në çështjet me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor” janë monitoruar 37 vendime gjyqësore, nga të cilat në 15 prej tyre gjykata është shprehur me vendim për caktimin e një mase konkrete të detyrimit ushqimor në favor të fëmijës së mitur. Këto vendime janë analizuar me kujdes për të marrë prej tyre të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në skedën monitoruese, të tilla si ndërgjyqësia, fati i gjykimit, provat e përdorura për të kuptuar sensibilizimin dhe trendin gjyqësor të çështjeve ndaj detyrimit për ushqim të prindit debitor ndaj fëmijëve të mitur dhe masës së këtij detyrimi, me një përkujdesje ndaj këndvështrimit të barazisë gjinore.

Në rastin e monitorimit të çështjeve gjyqësore në ekzekutim nga Zyra e Përmbartimit seleksionimi i vendimeve është bërë në bazë të dosjeve të cilat ishin në proces ekzekutimi gjatë vitit në monitorim, atij 2014 dhe vjelja e të dhënave për plotësimin e skedës është bërë në mënyrë mekanike duke dërguar në ambientet e Zyrës së Përmbartimit, studentë të skuadrës sonë *pro bono* të aktivizuar në implementimin e këtij projekti. Informacioni u mor nga arkivat e Zyrës së Përmbartimit Publik, Tiranë, për shkak se aksesimi në arkivat e tyre në formë elektronike nuk është i mundur për publikun.

Situata e ofruar nga monitorimi i çështjeve gjyqësore është parë në mënyrë të ndërthurur edhe me një analizë të kornizës ligjore që rregullon marrëdhëniet familjare, të drejtat dhe detyrat e prindërve në garantimin e kushteve dinjitoze për jetesë të fëmijëve të tyre të mitur, në respektim të standardeve ndërkombëtare dhe zbatim të akteve ndërkombëtare për njohjen e detyrimit për ushqim ndaj fëmijëve të mitur nga personat ligjërisht përgjegjës në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

# Kuadri Ligjor në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijët

## • Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) ka sanksionuar si një ndër parimet themelore të saj, parimin e barazisë së shtetasve para ligjit: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia...”. Kushtetuta është garantuesja themelore e të drejtës së çdo individit për t’u martuar dhe pasur një familje, e drejtë kjo që gëzon mbrojtjen e veçantë nga Shteti. Është detyrë e ligjvënësit dhe e qeverisë shqiptare që të marrin të gjitha masat e duhura për të rregulluar ligjërisht lidhjen dhe zgjidhjen e martesës. Neni 53 i Kushtetutës i kushtohet mbrojtjes së dy institucioneve më të rëndësishme të shoqërisë që lidhen me vetë ekzistencën e saj siç janë martesja dhe familja. Kushtetuta shqiptare i garanton këto të drejta. Ajo cilëson se “Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje; Martesja dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit; Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.”<sup>1</sup> Në këtë mënyrë Kushtetuta mbron familjen e krijuar nga martesja ashtu si dhe familjen e krijuar nga bashkëjetesa ose “bashkimit të lirë” të dy personave me gjini të ndryshme. Mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta gjen edhe familja e krijuar nga një nënë ose baba e/i pamartuar, duke garantuar shprehimisht barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martese me ata të lindurit nga martesja. Po në konceptin e familjes, Kushtetuta vendos menjëherë pas nenit 53 një nen që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve, sipas të cilit ata gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti<sup>2</sup>. Mbrojtja e fëmijëve nga ana ligjore është parë fillimisht duke ju siguruar atyre formalizmin e familjes, pra të drejtën për të pasur të njohur ligjërisht amësinë dhe atësinë si dhe gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale. Në këtë kuptim, koncepti kushtetues i familjes gjen plotësisht përputhje me Kodin e

1 Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. 2. Martesja dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. 3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

2 Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesja. 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Familjes i cili rregullon në mënyrë të veçantë marrëdhëniet familjare dhe tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kjo marrëdhënie prodhon për palët. Në këtë mënyrë konstatojmë se, tërësia e dispozitave kushtetuese garanton të drejtën për të krijuar një familje; të drejtën për të jetuar me / në familje; të drejtën për të respektuar barazinë bashkëshortore, si dhe garantimin e mbrojtjes së posaçme të fëmijëve, përmes një kuadri ligjor në përputhje me këto dispozita.

## • Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>3</sup> nuk ofron vetëm një panoramë të të drejtave të fëmijëve, por jep një radhitje të përgjegjësive kundrejt fëmijëve, të cilat shtetet janë të gatshme t'i njohin dhe mbrojnë. Si detyrime të drejtpërdrejta që burojnë nga kjo Konventë radhiten detyrimet në formën e dhënies së mundësisë për arsimim apo sigurimit të gjykimin të përshtatshëm; ose detyrime indirekte si p.sh. dhënia e mundësisë prindërve, familjes apo kujdestarëve për marrjen e përgjegjësive së kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijës.

Dy janë konceptet mbi të cilat bazohet Konventa:

1. Interesi më i mirë i fëmijës (Neni 3) i cili merr karakter detyrues për të gjitha masat që kanë në qendër të tyre fëmijët<sup>4</sup>.
2. Prindërit apo personat e tjerë përgjegjës duhen përkrahur dhe mbështetur gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, në respektim të interesit më të lartë të fëmijës.

Konventa shton të drejtat për pjesëmarrje të fëmijëve dhe njeh rëndësinë e informimit të vetë fëmijëve mbi të drejtat e tyre. Konventa është i pari akt ndërkombëtar që prek tema të tilla si: e drejta e rehabilitimit për fëmijët të cilët kanë përjetuar situata të tmerrshme dhe shfrytëzimin; detyrimi i qeverive për të zhdukur praktikat tradicionale, të dëmshme për shëndetin e fëmijëve. Kjo Konventë përfshin parime dhe standarde, që kanë në fokus të tyre veçanërisht adoptimet dhe me gjykimin e të miturve.

Neni 4 i Konventës përcakton detyrimin e shteteve për të bërë gjithçka është e nevojshme për zbatimin e konventës dhe për garantimin e realizimit të të drejtave ekonomike, sociale

3 Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 me Rezolutën Nr. 44/25. Ajo u firmos për një kohë të shkurtër nga 61 vende të botës, reagim ky i pashënuar më parë pas një marrëveshjeje të Kombeve të Bashkuara. Hyrja në fuqi e deklaratës më 2 shtator 1990 shënoi pikën kulminante të angazhimeve gati 70 vjeçare për ta bërë bashkësinë ndërkombëtare që të njohë nevojat e veçanta dhe ndjeshmërinë e fëmijëve. Dhjetë vjet pas aprovimit, ratifikimin e saj kanë mbetur ta nënshkruajnë vetëm dy shtete, Somalia dhe SHBA.

4 Neni 3 Konventa Për të Drejtat e Fëmijës: 1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. 2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislativë dhe administrative përkatëse. 3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.



dhe kulturore të fëmijëve, duke përdorur për këtë qëllim mjetet që kanë në dispozicion (...). Për këtë arsye, shteti duhet të marrë masa serioze për garantimin e burimeve financiare dhe njerëzore.

Konventa cilëson në preambulën e saj se “ familja [është] njësi themelore e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi”.

Të drejtat e Konventës mbështeten mbi parimet themelore të përgjithshme të cilat janë:

**Neni 2** mbi ndalimin e diskriminimit;

**Neni 3** mbi interesin më të mirë të fëmijës;

**Neni 6** mbi të drejtën për jetë, ekzistencë dhe zhvillim;

**Neni 12** mbi respektimin e pikëpamjeve të fëmijës.

- **Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore dhe Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore**

Detyrimi ushqimor është garancia për ti siguruar atij që ndodhet në një situatë nevojë një shërbim të vazhdueshëm ose periodik të gjithçkaje që është e nevojshme për të jetuar, shërbim i cili është i lidhur ngushtë me kushtet ekonomike të të detyruarit. Në sferën e detyrimeve ushqimore institucionet ndërkombëtare kanë përshkruar një rrugëtim drejt mbrojtjes së kreditorit si pala e dobët e raportit të cilës i nevojitet një mbrojtje e sigurt dhe e shpejtë duke ofruar instrumente dhe procedura njohjeje të vendimeve jo shumë formale me qëllim garantimin e zgjidhjeve të ngjashme dhe autonome ndaj legjislacioneve kombëtare.

Kuadri ligjor ndërkombëtar në sferën e detyrimeve ushqimore i njohur nga shteti shqiptar përmbledh: **Konventën mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore**<sup>5</sup> dhe **Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore**<sup>6</sup>. Këto Konventa ruajnë disa nga principet fundamentale të Konventave të Hagës të mëparshme<sup>7</sup> por që nuk ofrojnë një përkufizim konkret të asaj që nënkupton «*detyrimet ushqimore*», zgjerojnë fushën e tyre të aplikimit si dhe të gjitha ato detyrime ushqimore ndaj të rriturve si dhe sistemojnë

5 Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 10397, datë 17.3.2011, botuar në Fletore Zyrtare nr. 34, dt.7 Prill 2011, faqe 1205, dhe hyn në fuqi për RSH-në, më 1 Nëntor 2011.

6 Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 10398, datë 17.3.2011, botuar në Fletore Zyrtare nr. 34, dt.7 Prill 2011, faqe 1211, dhe hyn në fuqi për RSH-në, më 1 Dhjetor 2012.

7 Konventa e Hagës, 24 Tetor 1956, mbi Ligjin e aplikuar të detyrimeve ushqimore ndaj fëmijëve dhe Konventa e Hagës, 15 Prill 1958, mbi Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e detyrimeve martesore ndaj fëmijëve i cili fushën e aplikimit e ka të kufizuar vetëm në detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve të mitur legjitimë, jolegjitimë dhe të adoptuar jo të martuar dhe në moshë nën 21 vjeç. Ligji i aplikueshëm ishte ai i banesës së fëmijës në bazë të të cilës duhet të përcaktohen detyrimet ushqimore dhe masa e tyre, e deroguar e cila mund të aplikohet nga çdo shtet ligji kombëtar nëq kërkesa i shtrohet autoritetit të këtij shteti ose i mituri dhe debitori kanë shtetësinë e atij shteti apo debitori ka rezidencën në këtë shtet.

të gjitha ato raporte që janë rrjedhojë e marrëdhënieve familjare, të farefisnisë, martesës ose përgjegjësisë prindërore. Përsa i përket përcaktimit të ligjit të aplikueshëm, Konventa parashikon një sërë lidhjesh të ndërthura që ofrojnë një favorizim maksimal ndaj kreditorit të detyrimit ushqimor i cili meriton mbrojtjen totale ligjore.

Kështu **“Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”** përcakton fushën e zbatimit të saj që përfshin: “Një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor apo administrativ në një shtet kontraktues në lidhje me një detyrim ushqimor që rrjedh nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhjeje tjetër jo gjaku, duke përfshirë një detyrim ushqimor ndaj një të mituri, të lindur jashtë martese ndërmjet:

1. një përfituesi të detyrimit ushqimor dhe një ofruesi të detyrimit ushqimor; apo
2. një ofruesi të detyrimit ushqimor dhe një autoriteti publik, i cili pretendon rimbursimin e fitimeve të dhëna një përfituesi të detyrimit ushqimor”. (neni 1)

Kësaj fushe zbatimi, shtet kontraktues, në përputhje me nenin 34, i rezervon të drejtën për të mos njohur ose zbatuar: “1. një vendim ose marrëveshje në masën që kjo lidhet me një periudhë kohore pasi përfituesi i detyrimit ushqimor arrin moshën 21 vjeç ose martohet, përveç rasteve kur përfituesi është ose ka qenë bashkëshorti i ofruesit të detyrimit ushqimor; 2. një vendim ose marrëveshje në lidhje me detyrimet ushqimore:

- a) ndërmjet personave me lidhje farefisnore;
- b) ndërmjet personave me lidhje jo gjaku;

- 3) një vendim ose marrëveshje, nëse nuk parashikon pagesa periodike të detyrimit ushqimor.

Një shtet kontraktues që ka bërë një rezervë nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e kësaj Konvente për vendime ose marrëveshje të tilla që përjashtohen nga rezerva e tij” (neni 26)<sup>8</sup>

**Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore**<sup>9</sup> zbatohet për detyrimet ushqimore që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jo gjaku, duke përfshirë edhe një detyrim ushqimor ndaj një të mituri të lindur jashtë martese<sup>10</sup>. Edhe në këtë Konventë<sup>11</sup>, çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 24 të saj, mund të rezervojë të drejtën që të zbatojë këtë Konventë vetëm për detyrimet ushqimore: 1. ndërmjet bashkëshortëve dhe ish-bashkëshortëve; 2. në lidhje me një person që nuk ka arritur moshën e njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar.

8 Kjo Konventë zëvendëson, për sa u përket shteteve që janë palë në të, Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve për detyrimet ushqimore ndaj **fëmijëve**, e lidhur në Hagë më 15 prill 1958.

9 Kjo Konventë zëvendëson, në marrëdhëniet midis shteteve që janë palë në të, Konventën mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve, lidhur në Hagë, më 24 tetor 1956. Megjithatë, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për një shtet që, në bazë të rezervës së parashikuar në nenin 13, ka përjashtuar zbatimin e kësaj Konvente për detyrimet ushqimore në lidhje me një person, i cili nuk ka arritur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar. (Neni 18)

10 Neni 1 i saj **Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore** (lidhur më 2 tetor 1973)

11 Neni 13 po aty

Sipas Konventës së Hagës “**Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes**” të datës 23.11.2007, të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin 63/2012, “shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, (...) për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (...) në veçanti kur këta persona jetojnë në një shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës”. Interesat më të mira të fëmijës kanë rëndësi parësore dhe çdo fëmijë ka të drejtën e një standardi **të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social** (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, 1989 dhe Preambula e Konventës së Hagës, 2007). Pra, referuar detyrimeve të mësipërme, në funksion të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i cili përbën edhe një interes publik, autoritetet shtetërore duhet të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore të huaja për të zgjidhur çështjet **që kanë të bëjnë me interesat e fëmijëve**.

- **Kodi i Familjes**

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë<sup>12</sup> sanksionon të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore të cilat garantojnë, mbrojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhëniet familjare. Në respektim të Kushtetutës, Kodi i Familjes garanton dhe konsideron parësore mbrojtjen e të miturit dhe interesin më të lartë të tij<sup>13</sup>. Në Kodin e Familjes, në lidhje me marrëdhëniet e fëmijës me prindërit dhe familjen e tij ose me rastet që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijës etj, i kushtohet një rëndësi e veçantë të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjorë. Sipas këtij Kodi, prindërit përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre<sup>14</sup>, me një vëmendje të veçantë ndaj detyrimit dhe të drejtës së prindërve për tu kujdesur për ushqimin e fëmijës, arsimimin e tij, etj. Kodi i Familjes parashikon detyrën dhe të drejtën e prindërve për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët e lindur nga martesë ose jashtë martesë (neni 4), të cilët në rast nevojë ndihmohen nga shteti.

Neni 50 i K.Familjes parashikon se: “Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime. Nga martesë lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës”.

Neni 155 i K.Familjes parashikon: “Para se gjykata të marrë një vendim lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili duhet të japë mendim...”.

---

12 Ligj Nr.9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes

13 Neni 2 K.F Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

14 Neni 3 Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë.

Shteti dhe shoqëria duhet t’u oftojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 158 i K.Familjes parashikon: “Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. E drejta e vizitës dhe e banimit nuk mund t’i refuzohen..” Në këtë mënyrë prindi të cilit i është caktuar përgjegjësia prindërore me vendim gjykate duhet ti krijojë fëmijës kushte të mira familjare dhe shpirtërore, një ambient të qëndrueshëm si dhe të tregojë një përkujdesje dhe përkushtim më të madh lidhur me këtë fakt, ndërkohë që sipas nenit 158 të K.Familjes parashikohet që, prindi, të cilit nuk i është **lënë fëmija për rritje dhe edukim**, duhet të krijojë lidhje afektive me fëmijën duke patur një kontakt të shpeshtë me të si dhe detyrohet të kontribuojë në rritjen dhe edukimin e fëmijës së tij, kjo duke patur parasysh dhe faktin, gjendjen familjare, ekonomiko financiare të të dy palëve.

Neni 161 i K.Familjes parashikon: “Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën ...” Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se caktimi i shumës së nevojshme për shpenzimet që lidhen me fëmijën, do të shqyrtohet nga gjykata edhe në rast se palët nuk e kërkojnë. Kontributi material, është i një rëndësie parësore për mirërritjen e fëmijës, ndaj ligji ka konsideruar që përcaktimi i tij nuk mund t’i lihet ekskluzivisht prindërve të fëmijës. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, imponon ndërhyrjen e gjykatës, e cila sipas rastit, do të zgjidhë konfliktin ndërmjet prindërve nëse këta nuk bien dakord mbi masën e këtij detyrimi.

Në kushtet kur legjislacioni ynë familjar nuk e parashikon masën e detyrimit ushqimor, si përsa i përket përcaktimit të një kufiri minimal, ashtu dhe atij maksimal, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit, referuar kriterëve ligjore të parashikuara në nenet 158 dhe 201§2 të Kodit të Familjes, me të drejtë në përcaktimin e këtij kontributi kanë marrë në konsideratë raportin e burimeve të të ardhurave të paditësit/es me ato të paditurës/it dhe këto të ardhura në raport me nevojat e fëmijës/eve dhe mundësinë ekonomike të paditësit/es. Pra, gjykatat kanë caktuar masën e detyrimit ushqimor të paditësit/es për fëmijën/ët nisur nga raporti midis: (i) nevojave të fëmijës/ve dhe (ii) mundësive ekonomike të paditësit/es, mbi të cilin/ën bie ky detyrim dhe ato të paditurës/it, së cilës/it i është lënë fëmija/ët për rritje dhe edukim.

Neni 192 i Kodit të Familjes parashikon se: “Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijëve”.

Neni 196 i K. Familjes parashikon: “Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t’u jetë hequr përgjegjësia prindërore.

Neni 197/3 i K.Familjes parashikon: “Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç<sup>15</sup>”.

15 Neni 197 i Kodit të Familjes sipas të cilit: “Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç”.

Neni 201 parashikon se *“Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij”*.

Praktika gjyqësore ka vlerësuar se detyrimi për ushqim i fëmijëve ka të bëjë me mirëqenien materiale të fëmijëve, pra ai është detyrimi thelbësor që rrjedh nga përgjegjësia prindërore. Në caktimin e detyrimit për ushqim, gjykata nisat nga interesi më i lartë i fëmijës, por edhe nga burimet dhe kushtet konkrete ekonomike të palëve. Në caktimin e shumës si kontribut ushqimor, gjykata merr parasysh krahas gjendjes ekonomike të palës së paditur dhe nevojat më themelore e jetike të të paditurit edhe moshën dhe nevojat materiale të fëmijës së mitur për mirëritje dhe edukim.

Sipas praktikës gjyqësore, është theksuar se në çdo moment që situata ekonomike e njërit prej prindërve mund të ndryshojë, jo vetëm i/e padituri/a mund të kontribuojë vullnetarisht për mirëritjen e fëmijëve së/të tij/saj, por në çdo rast, bazuar në nenin 207 të Kodit të Familjes, secili nga prindërit ka të drejtë të kërkojë shtimin, heqjen ose pakësimin e detyrimit për ushqim.

Neni 209 i K.Familjes parashikon: *“Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht...”*.

Neni 210 i K.Familjes parashikon: *“Detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë...”*.

Neni 215 i K.Familjes parashikon: *“Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”*.

## • **Ligji për Të Drejtat e Fëmijës**

Ligji Nr.10 347, datë 4.11.2010 Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ka në fokus të tij përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën (Neni 1). Qëllimi i tij konsiston në mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; në marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesin më të lartë të tij; në marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës; si dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës (neni 2).

Si pjesë thelbësore të tij ligji mbështetet mbi parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si princip mbizotërues, në të gjithë vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose

legjislative. Ndër parimet e tjera, shtylla të këtij ligji, janë dhe ato të barazisë dhe eliminimit të të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura apo të bindjeve të prindërve / përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij. Ky ligj garanton respektimin e përgjegjësive, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën. Për fëmijën ky ligj kërkon krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim, respektimin e mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e saj (Neni 5).

Në nenin 8 të Ligjit në fjalë, njihet e drejta që ka fëmija për të qëndruar pranë prindërve të tij si dhe të mos ndahet prej tyre veçse kur një gjë e tillë është çmuar nga Gjykata e cila e ka vlerësuar se është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës<sup>16</sup>.

Në mbështetje të nenit 18, ligji garanton të drejtën për nivel jetese të përshtatshëm për fëmijën, kjo në përputhje me zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Një tjetër mbrojtje që garanton ligji është mbrojtja sociale<sup>17</sup> e cila i ofrohet të miturit nga prindit/përfaqësuesi ligjor, mbrojtje e cila jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Një garanci tjetër për mirëritjen dhe edukimin e fëmijës përbën ushtrimi i kujdesit prindëror që i siguron fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale. Për ushtrimin e përgjegjësive prindërore, prindi/kujdestari ligjor për të garantuar mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës u kërkon autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar<sup>18</sup>.

---

16 Neni 8 Ligji për të Drejtat e Fëmijëve - E drejta për të qëndruar me prindërit 1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. 2. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij. 3. Prindi/përfaqësuesi ligjor nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës. 4. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtar i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, të arrestuar, të burgosur, të internuar, të dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij. 5. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendndodhjen e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës.

17 Neni 20 Ligji për të drejtat e Fëmijës: E drejta për mbrojtje sociale 1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit ligjor, mbrojtje sociale, përfshirë dhe sigurimet shoqërore. 2. Mbrojtja, kur është e nevojshme, duhet të jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

18 Neni 28 Ligji për të drejtat e Fëmijës: Ushtrimi i kujdesit prindëror 1. Prindi/përfaqësuesi ligjor ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj. 2. Prindi/përfaqësuesi ligjor, për ushtrimin e përgjegjësive prindërore, ka të drejtë t'u kërkojë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës.



## 2. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore

### 2.1. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e martesës dhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët

Në kuadrin e projektit “Çështjet strategjike për mbrojtjen e të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe të prindërve në rastet me objekt zgjidhje martese”, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka monitoruar në total 655 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt zgjidhje martese dhe rregullimi i pasojave të saj. Në 11 nga çështjet e monitoruara, palët kanë kërkuar zgjidhjen e martesës përmes miratimit të akt marrëveshjes. Në 6 nga çështjet, Gjykata ka vendosur kthimin e akteve. Në një nga çështjet është kërkuar nga Gjykata vetëm ndryshimi i vendimit për sa i përket të drejtës së takimit. Në 139 raste, Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes, ndër të cilat në 137 çështje pala paditëse nuk është paraqitur në gjykim ose kur është paraqitur ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes. Në 1 çështje është shpallur moskompetenca dhe në 1 çështje është vendosur pushimi i gjykimit sepse çështja ishte në proces.

#### 2.1.1. Profili i palëve në çështjet me objekt “zgjidhje martese dhe caktimi i detyrimit ushqimor për fëmijët”;

Të dhëna në lidhje me palën paditëse/profili i palës paditëse

##### GJINIA E PALËS PADITËSE

Gjinia		
Përshkrimi	Nr.	%
Femër	411	62.7%
Mashkull	244	37.3%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 62.7 % të vendimeve gjyqësore të monitoruara, pala paditëse ka qenë femër dhe në 37.3 % të vendimeve të monitoruara pala paditëse ka qenë mashkull. Kjo e dhënë tregon se në përqindjen më të lartë të rasteve janë femrat që i drejtohen gjykatës me kërkesë padi për të zgjidhur martesën dhe për të rregulluar pasojat e saj.

## GJENDJA SOCIALE E PALËS PADITËSE

Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	162	24.7%
i/e vetëpunësuar	18	2.7%
i/e papunë	105	16.0%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	6	0.9%
në emigracion	7	1.1%
pa të dhëna	357	55%
<b>Totali</b>	<b>655</b>	<b>100%</b>

Nga monitorimi ka rezultuar se në 24.7 % të rasteve pala paditëse ka qenë e/i punësuar, në 2.7 % ka qenë i/e punësuar, në 16 % të rasteve ajo ka qenë e /i papunë, në 0.9 % të rasteve pala paditëse ka qenë përfitues i ndihmës ekonomike dhe në 1.1 % ka rezultuar në emigracion. Rezulton se në 55 % të rasteve nuk ka të dhëna në lidhje me gjendjen sociale të palës paditëse.

## VENDBANIMI I PALËS PADITËSE

Në 7.9 % të rasteve pala paditëse jeton jashtë vendit.

## ARSIMI I PALËS PADITËSE

Arsimi		
Përshkrimi	Nr.	%
fillor	4	0.6%
9 vjeçar	87	13.3%
i mesëm	103	15.7%
i lartë	67	10.2%
Nuk ka të dhëna	394	60.2%

Në lidhje me arsimimin e palës paditëse ka rezultuar se në 15.7 % të rasteve ajo është me arsim të mesëm, në 13.3 % të rasteve pala paditëse është me arsim 9 vjeçar, në 10.2 % të rasteve pala paditëse është me arsim të lartë dhe në 0.6 % të rasteve ajo është me arsim fillor. Nga monitorimi ka rezultuar se në një përqindje të lartë të rasteve në 60.2 % nuk ka të dhëna në lidhje me arsimin e palës paditëse.



## MOSHA E PALËS PADITËSE

Nga monitorimi kanë rezultuar të dhëna me interes në lidhje me moshën e palës paditëse.

Mosha		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	33	5.0%
16 vjeç	1	0.2%
25-35 vjeç	265	40.5%
35-45 vjeç	284	43.4%
Mbi 45 vjeç	67	10.2%
Nuk ka të dhëna	6	0.9%

Kështu, mosha e palës paditëse në 43.4 % të rasteve është e grupmoshës 35-45 vjeç. Në 40.5 % të rasteve mosha e palës paditëse është 25-35 vjeç, në 5 % të rasteve i përket grupmoshës 18-25 vjeç, në 0.2 % të rasteve pala paditëse i përket grupmoshës tjetër dhe në 0.9 % të rasteve nuk ka të dhëna në lidhje me moshën e saj.

## MARRËDHËNIA E PALËS PADITËSE ME PERSONAT PËR TË CILËT KËRKOHET DETYRIMI USHQIMOR

Cila është marrëdhënia e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor		
Përshkrimi	Nr.	%
prindi	643	98.2%
vetë fëmija	0	0.0%
kujdestari ligjor i fëmijës	0	0.0%
përfaqësuesi ligjor i fëmijës	0	0.0%
tjetër	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	12	1.8%

Në 98.2 % të rasteve, pala paditëse është prindi i cili kërkon detyrimin ushqimor për fëmijët. Vetëm në 1.8 % të rasteve nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me marrëdhënien e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor. Kjo mungesë të dhënash në lidhje me marrëdhënien e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor lidhet edhe me vendimet e pushimit të cilat nuk të mundësojnë informacion në lidhje me këtë marrëdhënie.

## NUMRI I FËMIJËVE

NUMRI I FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
1 fëmijë	288	44.0%
2 fëmijë	245	37.4%
3 fëmijë	56	8.5%
më shumë se tre fëmijë	35	5.3%
Nuk ka të dhëna	31	4.7%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 44% të rasteve pala paditëse është me 1 fëmijë, në 37.4 % të rasteve pala paditëse është me 2 fëmijë, në 8.5 % të rasteve pala paditëse është me 3 fëmijë, në 5.3 % të rasteve pala paditëse ka më shumë se tre fëmijë dhe vetëm në 4.7 % të rasteve nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me numrin e fëmijëve të palës paditëse.

## MOSHA E FËMIJËVE

MOSHA E FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
< 1 vjeç	32	6.3%
2 -5 vjeç	176	34.5%
6-10 vjeç	200	39.2%
11 -18 vjeç	230	45.1%
19- 25 vjeç (në 4 raste ka caktuar DU)	54	10.6%
Nuk ka të dhëna	137	26.9%

Në lidhje me moshën e fëmijëve, ka rezultuar se në 45.1 % të rasteve fëmijët janë të grupmoshës 11-18 vjeç, në 39.2 % të rasteve fëmijët janë të grupmoshës 6-10 vjeç, në 34.5 % të rasteve ata janë të grupmoshës 2-5 vjeç, në 10.6 % të rasteve fëmijët i përkasin grupmoshës 19-25 vjeç dhe në 6.3 % të rasteve fëmijët janë 1 vjeç. Në 26.9 % të rasteve mungojnë të dhënat në lidhje me moshën e fëmijëve.

***Pra, profili i palës paditëse në çështjet me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj është kryesisht një grua, e punësuar, që jeton brenda vendit, me arsim të mesëm, që i përket grupmoshës 35-45 vjeç, me një fëmijë, të moshës 11-18 vjeç, e cila kërkon detyrimin ushqimor për fëmijët.***

## PROFILI I PALËS SË PADITUR

Gjatë monitorimit të vendimeve gjyqësore me objekt “Zgjidhje Martese”, një rëndësi e veçantë i është dhënë përpunimit të të dhënave mbi gjendjen sociale të palëve dhe në rastin e palës së paditur bie në sy që numrin më të madh të tyre e përbëjnë personat e punësuar me 17.4%, ata të papunë me 17.3%, të vetëpunësuar me 2.7% dhe përfitues të ndihmës ekonomike me 1.2 %. Një tjetër element i kërkimit tonë ishte dhe vendbanimi i tyre nga i cili rezultoi se 48.2 % e palëve jetojnë brenda vendit. Në 9 raste kjo palë vuan dënim penal në vendet e vuajtjes së dënimit dhe në një prej tyre pala e paditur është e strehuar në një rezidencë. Pjesa tjetër e cila jeton jashtë vendit përbën 9.6% të totalit të rasteve të monitoruara ku në vendime specifike është përcaktuar që jetojnë në emigracion (2%)

Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	114	17.4%
i/e vetëpunësuar	18	2.7%
i/e papunë	113	17.3%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	8	1.2%
në emigracion	13	2.0%
Jeton brenda vendit	316	48.2%

Jeton jashtë vendit	63	9.6%
Tjetër (-9 raste-Vuan nje dënim penal dhe -1 rast në rezident në OJF)	10	1.5%
<b>Arsimi</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
fillor	6	0.9%
9 vjeçar	63	9.6%
i mesëm	71	10.8%
i lartë *	53	8.1%
Nuk ka të dhëna	462	70.5%

Nga të dhënat e mbledhura mbi nivelin arsimor për palën e paditur del që 10.8% e tyre janë me arsim të mesëm, 9.6% me arsim 9 vjeçar, 8.1% me arsim të lartë dhe 0.9% me atë fillor. Këto të dhëna janë nxjerrë nga ato vendime të cilat kanë përcaktuar të dhëna specifike për arsimin ndërkohë që 70.5% e vendimeve të monitoruara nuk paraqesin asnjë të dhënë mbi këtë element.

<b>Cila është marrëdhënia e palës së paditur me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
bashkëshort	4	0.6%
bashkëjetues	0	0.0%
prindi	634	96.8%
vetë fëmija	0	0.0%
kujdestari ligjor i fëmijës	0	0.0%
përfaqësuesi ligjor i fëmijës	0	0.0%
tjetër	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	0	0.0%

Në rastin e monitorimit të marrëdhënies së palës së paditur me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor, pjesa më e madhe rezulton të jenë prindër me 96.8% dhe pjesa tjetër bashkëshortë me 0.6%. Kjo tregon që edhe pse në Kodin e Familjes është përcaktuar detyrimi ushqimor për bashkëshortët pas Zgjidhjes së martesës, rastet e kërimit të tij nga palët janë sporadike për mos të thënë inekzistente, kjo e varur ndoshta nga gjendja e tyre ekonomike, mungesa e praktikës ligjore në këtë drejtim apo hezitimit të palës së paditur e cila është e prirur drejt zgjidhjes me çdo kusht e sa më parë të martesës.

<b>NUMRI I FËMIJËVE</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
1 fëmijë	290	44.3%
2 fëmijë	246	37.6%
3 fëmijë	62	9.5%
më shumë se tre fëmijë	13	2.0%
Nuk ka të dhëna	44	6.7%

Sipas të dhënave të nxjerra nga monitorimi mbi numrin e fëmijëve të palës paditëse, pjesa më e madhe e tyre rezulton që ka një fëmijë konkretisht 44.3%, dy fëmijë kanë 37.6%, tre fëmijë 9.5% dhe më shumë se tre fëmijë janë 2% e personave, pjesë e palës së paditur. Vlen të përmendet që 6.7 % e vendimeve nuk ofrojnë asnjë të dhënë mbi numrin e fëmijëve të palës së paditur.

Moshë		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	29	4.4%
25-35 vjeç	222	33.9%
35-45 vjeç	282	43.1%
Tjetër	103	15.7%
Nuk ka të dhëna	0	0.0%

Në rastin e të dhënave të mbledhura mbi moshën e palës së paditur rezulton se grupi më i madh përbëhet nga persona të grup moshës nga 35-45 vjeç me 43.1%, e ndjekur nga grup moshë 25-35 vjeç me 33.9%, grupmosha të tjera figurojnë të jenë në % 15.7 dhe grupmosha 18-25 vjeç me 4.4%.

### 2.1.2. Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “zgjidhjen e martesës dhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët”;

Janë gjykuar 510 çështje dhe 145 çështje janë pushuar ose i janë kthyer aktet palës paditëse. Numri i vendimeve të pushimit ngre çështje të efekteve negative që këto vendime sjellin mbi interesin më të lartë të fëmijëve dhe caktimin e masës së detyrimit ushqimor.

Në dy raste gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar që të caktohet një vlerë minimale për shkak të detyrimit ligjor.

Në dy raste gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar që secilit bashkëshort ti lihet për rritje dhe edukim një fëmijë dhe të mos paguajnë detyrim ushqimor për njëri tjetrin.

#### KËRKIMI NGA PALA PADITËSE E MASËS SË DETYRIMIT USHQIMOR PËR FËMIJËT

*Dispozitat e Kodit të Familjes nuk përcaktojnë një kufi minimal dhe maksimal të masës së detyrimit ushqimor, pavarësisht nenit 201, “Kufijtë e detyrimit për ushqim”. Legjislacione të ndryshme kanë parashikuar kufij minimal ose maksimal të masës së detyrimit ushqimor.*

Në këto kushte në disa raste pala paditëse kërkon një masë të caktuar të detyrimit ushqimor dhe në disa raste e lë në çmim të gjykatës përcaktimin e masës së detyrimit ushqimor. Kjo ka sjellë që gjykatat e rretheve gjyqësore të përcaktojnë masën e detyrimit ushqimor rast pas rasti, pasi ka rezultuar se fëmija është në nevojë. Praktikrat gjyqësore në përcaktimin e masës së detyrimit ushqimor, gjithashtu kanë shërbyer si një pikë orientimi si për palët ashtu edhe për gjyqtarët.

**A ka kërkuar paditësi paraprakisht në kërkesë padi një masë detyrimi ushqimor për fëmijët?**

Përshkrimi	Nr.	%	<b>Nëse po sa është shuma e kërkuar për secilën fëmijë?</b>		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	355	54.2%	<i>Nuk ka përcaktuar shumën</i>	270	76.1%
			500	1	0.3%
			2000-5000	6	1.7%
			6000-8000	6	1.7%
			10000 – 15000	48	13.5%
			20000 – 30000	20	5.6%
			40000 – 60000	3	0.8%
			80000 lekë + shpenzimet e formimit profesional	1	0.3%
<b>JO</b>	300	45.8%			

Nga monitorimi ka rezultuar se, pala paditëse ka kërkuar paraprakisht në kërkesë padi masën e detyrimit ushqimor për fëmijët në 54.2 % të rasteve. Nga këto raste, në 76.1 % pala paditëse nuk e ka përcaktuar shumën e kërkuar për secilin fëmijë, në 13.5 % është përcaktuar shuma 10.000-15000 lekë, në 5.6 % është përcaktuar shuma 20.000-30.000 lekë, në 1.7 % të rasteve është kërkuar shuma 2000-5000 lekë, në 1.7 % të rasteve është kërkuar shuma 6000-8000 lekë, në 0.8 % të rasteve është kërkuar shuma 40.000-60.000 lekë, në 0.3 % është kërkuar shuma 500 lekë dhe në 0.3 % të rasteve është kërkuar shuma 80.000 lekë dhe shpenzimet e formimit profesional.

Në 45.8 % të rasteve pala paditëse nuk ka kërkuar paraprakisht masën e detyrimit ushqimor për fëmijët.

Nga tabela rezulton se në një përqindje të lartë të rasteve, pala paditëse nuk e ka përcaktuar shumën e kërkuar si masë detyrimi ushqimor, duke vlerësuar se është gjykata që në bazë të kërkesave të fëmijëve dhe mundësive të prindit tjetër përcakton masën e detyrimit ushqimor. Shuma e kërkuar në përqindjen më të lartë të rasteve është 10.000-15.000 lekë për secilën fëmijë.

Nga monitorimi janë identifikuar raste, ku gjykata nuk mban parasysh pretendimet e palëve për të mos caktuar detyrimin ushqimor të bashkëshortit tjetër për fëmijët. Gjykata ka caktuar detyrimin ushqimor, duke mbajtur parasysh detyrimin ushqimor për fëmijët, pavarësisht kërkesës së palës paditëse për të mos caktuar detyrim ushqimor për fëmijën/t<sup>19</sup>. “Kontributi material është i një rëndësie parësore për mirëritjen e fëmijës, ndaj ligjvënësi ka konsideruar që përcaktimi i tij nuk mund ti lihet ekskluzivisht vlerësimit të prindërve të fëmijës”<sup>20</sup>.

Në rastet kur prindit të cilit i lihet fëmija për rritje dhe edukim merr përsipër të përmbushë i vetëm kontributin material për fëmijët, gjykata duhet të çmojë nëse kjo është në pajtim me interesin më të lartë të fëmijës/ve.

19 Shih vendimin nr. 43994, datë 7.4.2014.

20 S.Omari, “E drejta Familjare”, fq.321, Tiranë 2007.

“...gjykata do të miratojë heqjen dorë nga e drejta e fëmijës, vetëm nëse gjatë gjykimit vërtetohet se mundësitë materiale të prindit që i është besuar fëmija, janë të mjaftueshme për të siguruar jetesën në kushte optimale të fëmijës.”<sup>21</sup>

Edhe nga formulimi i nenit 161 të Kodit të Familjes, rezulton se gjykata cakton kontributin për detyrimin ushqimor për fëmijën, edhe në rast se palët nuk e kërkojnë.

Të dhëna të detajuara për masën e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata na jep tabela më poshtë:

<b>Arsyet pse kërkohet pensioni ushqimor për fëmijët në masën e kërkuar?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
Mosha	36	7.06%
shpenzimet e rritjes së fëmijës	162	31.76%
Arsimimi	25	4.90%
shpenzime plotësuese për mirë edukimin dhe veprimtaritë extrashkollore të fëmijës	0	0.00%
probleme shëndetësore të fëmijës	1	0.20%
<b>arsye të tjera:</b> 1. Detyrimi reciprok dhe zgjidhja e pasojave të zgjidhjes së martesës 33 raste 2. Kushtet ekonomike dhe vetëm në këtë masë prindi tjetër ka mundësi të paguajë 3 raste 3. Ka në ngarkim kredi bankare 3 raste	39	7.65%

Rezulton qartë se detyrimi për ushqim nuk përfshin vetëm shpenzimet e domosdoshme për të përballuar nevojat jetësore por edhe shpenzime të tjera që lidhen me arsimimin e fëmijës, veprimtaritë extra kurrikulare apo problemet shëndetësore. Pra shumica e caktuar për tu paguar nga prindi të cilit nuk i është besuar fëmija, do të përdoret nga prindi të cilit i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, për shpenzimet e nevojshme të mirërritjes, edukimit dhe arsimimit të fëmijët.

Nga monitorimi ka rezultuar se 31.76 % të rasteve, pala paditëse e ka arsyetuar masën e detyrimit ushqimor të kërkuar me shpenzimet e nevojshme për rritjen e fëmijës, në 7.6 % të rasteve pala paditëse e ka arsyetuar masën e kërkuar të detyrimit ushqimor me moshën e fëmijës, në 7.65 % të rasteve pala paditëse ka dhënë arsye të tjera si detyrimi reciprok i prindërve për të kontribuar për rritjen e fëmijëve, kushtet ekonomike dhe mundësitë e prindit tjetër, si edhe faktin që prindi tjetër ka në ngarkim shlyerjen e një kredie bankare. Në 4.9 % të rasteve pala paditëse e ka arsyetuar masën e detyrimit ushqimor me shpenzimet për arsimin e fëmijëve dhe në 0.2 % të rasteve pala paditëse e ka arsyetuar masën e detyrimit ushqimor të kërkuar me problemet shëndetësore të fëmijës dhe shpenzimet e nevojshme për këtë qëllim. Ndonëse për arsye studimi ne i kemi detajuar arsyet e dhëna nga pala paditëse për masën e detyrimit ushqimor të kërkuar, në arsyen e dhënë “shpenzimet e rritjes së fëmijës”,

21 S.Omari, “E drejta Familjare”, fq.1321, Tiranë 2007.

pala paditëse mund të ketë pasur në vëmendje si moshën, arsimimin apo nevoja të tjera të fëmijës.

## PROVAT QË KANË PARAQITUR PALËT

<b>Çfarë provash kanë paraqitur palët dhe ku mbështeten në kërkesat për detyrimin ushqimor?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
vërtetim mbi të ardhurat e palëve	114	22.4%
vërtetim nga shkolla e fëmijëve	21	4.1%
raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve	9	1.8%
vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore	1	0.2%
<b>të tjera:</b> 1. <i>Certifikatë</i> 2. <i>Dëshmi hipotekore, Marrëveshje, Kredi, Urdhër mbrojtje</i>		
<b>Totali</b>	<b>510</b>	<b>100.0%</b>

Prova kryesore ku mbështeten kërkesat për detyrim ushqimor është vërtetimi mbi të ardhurat e palëve. Rezultoni nga vendimet e monitoruara se vërtetimi mbi të ardhurat e palëve është paraqitur në 22.4 % të rasteve. Prova të tjera të paraqitura nga palët janë: vërtetim nga shkolla e fëmijëve në 4.1 % të rasteve, raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve në 1.8 % të rasteve, vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore në 0.2 % të rasteve. Në raste të tjera Certifikata, Dëshmi hipotekare, Marrëveshje, Kredi dhe vendime të lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes janë paraqitur si prova në mbështetje të kërkesës për detyrim ushqimor.

Megjithëse prova kryesore ka rezultuar vërtetimi mbi të ardhurat e palëve, nga monitorimi janë identifikuar raste ku gjykata është bazuar në caktimin e masës së detyrimit ushqimor tek thëniet e palëve<sup>22</sup> për të ardhurat e palëve. Megjithëse, prova të tjera që vërtetojnë mënyrën e jetesës së njërit prind janë të rëndësishme në mungesë të provave që vërtetojnë nivelin e të ardhurave, mendojmë se thëniet për të ardhurat e palëve janë të pamjaftueshme për të përcaktuar mundësitë ekonomike të prindit.

### Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<b>Cilat ishin arsyet e parashtruara nga gjykata për caktimin e detyrimit ushqimor në masën konkrete:</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
Nevojat e fëmijës, specifiko (ushqim, veshje dhe arsimim)	338	66.3%
mundësitë ekonomike të palës paditëse	297	58.2%

22 Shih vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.4663, datë 11.04.2014.



**Cilat ishin arsyet e parashtruara nga gjykata për caktimin e detyrimit ushqimor në masën konkrete:**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
mundësitë ekonomike të palës së paditur	296	58.0%
kërkesën e palës paditëse	8	1.6%
kërkesën e palës së paditur	7	1.4%
Koha që qëndron me secilin prind	2	0.4%
Niveli i jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit.	112	22.0%
Vlerën ekonomike të punëve të shtëpisë dhe kujdesin që merr nga të dy prindërit.	1	0.2%
Shpenzimet shkollore për fëmijën	10	2.0%
Shpenzimet shkollore për fëmijën, (tarifat e detyrimeve shkollore, tekstet dhe kancelaritë, etj)	2	0.4%
Shpenzimet jashtëshkollore për fëmijën (kurse, aktivitete, si gjuhë e huaj, kurse profesionale, rrethe sportive)	3	0.6%
Banesa bashkëshortore? Përfitimi i shtëpisë bashkëshortore? (vlera e mundshme e qirasë së pronës?)	3	0.6%
<b>të tjera 13 raste</b> (marrëveshje) <b>48 raste</b> (gjykata nuk shprehet tek pjesa arsyetuese e vendimit por e gjejmë të pasqyruar vetëm në dispozitiv) <b>70 raste</b> 1. puna e informalizuar është një fenomen i përhapur dhe nuk ka një mënyrë për të vërtetuar të ardhurat e palëve; 2. gjykata mbështetet në pohimet e palëve; 3. gjykata mbështetet në pagën minimale në shkallë vendi; 4. fëmijët e mitur janë në një moshë kur kërkesat vijnë në rritje; 5. gjykata mbështetet tek të ardhurat e të dy prindërve 6. gjykata mbështetet në nevojat për rritje dhe edukim të shëndetshëm të fëmijëve 7. gjykata mbështetet në ruajtjen e standardit të jetesës pas zgjidhjes së martesës)	131	25.7%
nuk ka të dhëna	0	0.0%

Tabela e mësipërme tregon qartë se Gjykata në përcaktimin e masës së detyrimit ushqimor ka zbatuar nenin 201, paragrafi i dytë i Kodit të Familjes si edhe nenin 158. Neni 201 i Kodit të Familjes parashikon që detyrimi për ushqim mund të kërkohej vetëm nga një person në



nevojë, që nuk është në gjendje të përmbushë nevojat e tij dhe në raport me nevojat. Ky nen kërkon që gjykata të konsiderojë jo vetëm nevojat e kërkuarit por edhe mundësitë ekonomike të për prindit që do të detyrohet të paguajë pensionin ushqimor. Ky nen përcakton si kufi maksimal, “atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin ushqimor” duke bërë që gjykata të shqyrtojë rast pas rasti nevojat e kërkuarit duke mbajtur parasysh rrethanat e jetës së kërkuarit si edhe sa mundësi ekonomike ka prindi që detyrohet të paguajë pensionin ushqimor ti përmbushë këto rrethana. Edhe neni 158 i Kodit të Familjes parashikon se prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër.

Përcaktimi i mundësive ekonomike të prindit nuk duhet të bazohet vetëm në të ardhurat e secilit prind por edhe në të ardhurat që burojnë nga pasuria e secilit prind. Nga provat e paraqitura dhe arsyetimi i vendimit rezultojnë një numër i kufizuar rastesh për të cilat gjykata vlerëson mundësitë ekonomike edhe në të ardhurat nga pasuria e secilit prind. Edhe praktika e avokateve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare e konfirmon këtë konkluzion. Mungojnë rastet kur prindi tjetër tju jetë drejtuar institucioneve si ZRPP, Zyra e Tatimeve apo institucioneve të tjera pranë të cilave mund të sigurohet informacion mbi gjendjen pasurore të prindit tjetër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka mbështetur vendimin mbi masën e detyrimit ushqimor në arsyet si më poshtë: Në 66.3%, gjykata e ka mbështetur vendimin e saj në nevojat e fëmijës, si nevojat për ushqim, arsimim, etj; në 58.2% në mundësitë ekonomike të palës paditëse, në 58.0% në mundësitë ekonomike të palës së paditur, në 22.0% të rasteve gjykata është mbështetur në nivelin e jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit, në 2% të rasteve në shpenzimet shkollore për fëmijën, në 1.6% gjykata është mbështetur në kërkesën e palës paditëse, në 1.4% në kërkesën e palës së paditur, në 0.6% gjykata është mbështetur në shpenzimet jashtë shkollore për fëmijën si kurse, aktivitete të ndryshme si gjuhë e huaj, kurse profesionale, rrethe sportive, etj. dhe në 0.6% të rasteve gjykata e ka lidhur vendimin e saj mbi detyrimin ushqimor me të drejtën e përfitimit të banesës bashkëshortore.

Rezulton nga tabela, se gjykata është referuar në moshën e fëmijëve, në gjendjen shëndetësore dhe rrethana të tjera për të përcaktuar nevojat e fëmijës.

Nga monitorimi janë identifikuar vendime, ku masa e detyrimit ushqimor rezulton vetëm në dispozitivin e vendimit dhe nuk është arsyetuar se cilët janë faktorët mbi të cilët gjykata mbështetet për të përcaktuar masën e detyrimit ushqimor<sup>23</sup>.

Ka rezultuar në një nga vendimet e monitoruara se gjykata nuk ka caktuar detyrim ushqimor sepse palët, prindërit e fëmijëve ishin të papunë<sup>24</sup>. Kodi i Familjes në nenin 196, “Pamundësia e dhënies së detyrimit për ushqim” parashikon se prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur tu jetë hequr përgjegjësia prindërore.

23 Shih Vendimin nr.11931, datë 15.12.2014; Vendimi nr.11888, datë 15.12.2014; Vendimi nr.11887, datë 12.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

24 Vendimi nr.12460, datë 30.12.2014.

Në rastet kur palët ndërgjyqëse kanë nga një fëmijë në përgjegjësi, gjykata nuk ka vendosur detyrim ushqimor të prindërve mbi fëmijën<sup>25</sup>. Ndonëse kjo zgjidhje realizon një kompensim gjyqësor, është e rëndësishme që para se të gjykata të marrë një vendim kompensimi të bëjë vlerësimin e nevojave të secilit fëmijë dhe mundësive ekonomike, para se të marrë vendimin kompensues.

Në një nga vendimet e monitoruara, rezultoi se gjykata duhet të caktonte detyrimin ushqimor për fëmijën madhor, por gjykata nuk e caktoi sepse fëmija madhor hoqi dorë nga detyrimi ushqimor. Bazuar në nenin 214 të Kodit të Familjes, heqja dorë nga e drejta për të marrë detyrimin për ushqim për kohën e ardhshme është e pavlefshme.

Nga monitorimi kanë rezultuar vendime të arsyetuara me profesionalizëm ku arsyetohet masa e detyrimit ushqimor duke e shpjeguar me disa faktorë si nevojat e fëmijës, të ardhurat e palës paditëse dhe të paditurit, si edhe mos ndryshimi i nivelit të jetesës së fëmijës si pasojë e zgjidhjes së martesës së bashkëshortëve, prindër të fëmijës/ve<sup>26</sup>.

Masa e detyrimit ushqimor

A është masa e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata		
Përshkrimi	Nr.	%
Nuk është shprehur mbi shumën e detyrimit ushqimor	330	64.7%
e njëjtë me atë të kërkuar nga pala paditëse?	94	18.4%
më e ulët se masa e kërkuar?	59	11.6%
më e lartë se masa e kërkuar?	21	4.1%
nuk ka të dhëna	3	0.6%

Ka rezultuar se në 64.7 % të rasteve, gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është shprehur mbi masën e detyrimit ushqimor; në 18.4 % të rasteve gjykata ka vendosur detyrimin ushqimor në të njëjtën masë me atë të kërkuar nga pala paditëse; në 11.6 % gjykata ka vendosur detyrimin ushqimor në një masë më të ulët se masa e kërkuar; në 4.1 % të rasteve gjykata ka vendosur detyrimin ushqimor në një masë më të lartë se masa e kërkuar dhe vetëm në 0.6 % të rasteve nuk ka të dhëna mbi masën e detyrimit ushqimor të caktuar nga Gjykata. Mendojmë se % prej 64.7 % e rasteve në të cilat gjykata nuk është shprehur mbi shumën e detyrimit ushqimor lidhet me vendimet e pushimit, me çiftet pa fëmijë dhe fëmijë madhorë të çiftit.

## DETYRIMI USHQIMOR PËR ISH-BASHKËSHORTIN

### Kërkimi nga pala paditëse

Nga monitorimi ka rezultuar se vetëm në 0.4 % të rasteve, pala paditëse ka kërkuar detyrim ushqimor për vetë personin. Në një nga rastet masa e detyrimit ushqimor është lënë në çmim të gjykatës dhe në rastin tjetër pala paditëse ka kërkuar kontribut kompensues në vlerën 8.000 lekë/muaj, deri në pjesëtimin e pasurisë.

<sup>25</sup> Shih vendimin nr.10792, datë 10.11.2014.

<sup>26</sup> Vendim nr.1035, datë 28.01.2014, i dhënë nga gjyqtarja T.H.

A ka kërkuar pala paditëse detyrim ushqimor për vete? Po/Jo					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po, masa e detyrimit ushqimor është rritur:		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	2	0.4%	Në çmim të gjykatës	1	50%
			kontribut kompensues në vlerën 8.000 lekë/muaj, deri në pjesëtimin e pasurisë	1	50%
<b>JO</b>	508	99.6%			

Vetëm në një nga rastet pala paditëse ka kërkuar detyrim ushqimor për vete. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dhënë detyrimin ushqimor për palën e paditur për dy vjet<sup>27</sup>.

Tabela tregon qartë se neni 147 i Kodit të Familjes “Kontributi kompensues” nuk gjen zbatim në praktikë. Nga monitorimi ka rezultuar se pala paditëse vetëm në një rast ka kërkuar nga gjykata të detyrojë bashkëshortin tjetër të derdhë për llogari të saj/tij një kontribut për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim.

Ky konkluzion është në përputhje me gjetjet e raportit të QNLQ, “Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor”<sup>28</sup>.

## VENDIMI I GJYKATËS PËR CAKTIMIN E DETYRIMIT USHQIMOR

A ka dhënë gjykata vendim për caktimin e një detyrimi ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike? <i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	1	0.2%
<b>JO</b>	509	99.8%

Nga monitorimi ka rezultuar se vetëm në një rast ose në 0.2 % të rasteve gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dhënë vendim për caktimin e një detyrimi ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike. Në 99.8 % të rasteve gjykata nuk ka caktuar detyrim ushqimor për ish bashkëshortin në vendimet e saj.

27 Shih vendimin nr.2870, datë 28.02.2014.

28 QNL, Raport, “Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor”, Tiranë 2013, fq.44.

## PËRFAQËSIMI I PALËS PADITËSE ME AVOKAT

<b>Është përfaqësuar pala paditëse me avokat?</b>					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse përgjigja është po, specifikoni nëse pala paditëse është përfaqësuar nga		
			Përshkrimi	Nr.	%
Po	335	51.1%	Avokat nga NGO	29	9%
			Avokat Privat	308	92%
			Avokat falas nga KSHNJ	1	0%
Jo	320	48.9%			

Nga monitorimi ka rezultuar se pala paditëse është përfaqësuar me avokat në 51.1 % të rasteve dhe nuk është përfaqësuar me avokat në 48.9 % të rasteve.

Nga rastet e përfaqësuar me avokat, në 92 % të rasteve pala paditëse është përfaqësuar me avokat privat, në 9 % të rasteve pala paditëse është përfaqësuar me avokat nga organizatat jofitimprurëse dhe vetëm në një rast pala paditëse është përfaqësuar me avokat falas nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën juridike. Nga tabela vihet re qartë se në përqindjen më të lartë të rasteve pala paditëse është përfaqësuar nga avokat privat. Tabela tregon se organizatat jofitimprurëse luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e asistencës ligjore për palët. Roli i Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike megjithë kuadrin ligjor të përmirësuar mbetet ende i vakët. Ky konkluzion evidenton që ky institucion nuk njihet sa duhet, qytetarët nuk i drejtohen për të përfituar ndihmë ligjore falas dhe puna e vetë Komisionit nuk ka krijuar besimin e duhur të qytetarëve që mund të përfitojnë shërbim ligjor falas nëse përmbushin kushtet e parashikuara në ligj. Nga ana tjetër mungesa e transparencës së këtij institucioni, vazhdimësia e mbështetjes së klientëve në nivel rasti dhe jo nëpërmjet kontraktimit të organizatave jofitimprurëse të specializuara në ofrimin e shërbimit ligjor falas, shpjegojnë këtë rezultat.

<b>A është dëgjuar në seancë mendimi i ekspertit psikolog /punonjës social në dhënien e vendimit të gjykatës?</b>		
<i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	509	77,7%
<b>JO</b>	0	0,0%
<b>Vendime të pushuara</b>	146	22,3%

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore “Për ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor”, rezulton se në 77.7% të tyre është dëgjuar në seancë mendimi i ekspertit psikolog /punonjës social, mendim i cili është pasqyruar në dhënien e vendimit të gjykatës. Rastet kur mendimi i psikologut apo punonjësit social nuk është marrë në konsideratë janë zero gjë që tregon se gjykata ka qenë e prirur dhe e gatshme **të respektojë ligjin, Kodin e Familjes** i cili e detyron atë të thërrasë një ekspert (psikologut apo punonjësit social) në respektim të interesit më

të lartë të fëmijës. Aq e dukshme është kjo tendencë sa jepet edhe në shifrat e paraqitura ku 22.3% e pjesës mbetëse të vendimeve rezultojnë të jenë të pushuara dhe nga vendimi gjykata bën me dije që gjatë hetimit gjyqësor psikologu/punonjësi social është thirrur nga gjykata edhe pse **çështja në shqyrtim është pushuar për arsye të ndryshme.**

<b>A është konkluzioni i ekspertit të çështjes i njëjtë me atë të gjykatës?</b> <i>Po/Jo</i>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
<b>PO</b>	509	77,7%
<b>JO</b>	0	0,0%
<b>Vendime të pushuara</b>	146	22,3%

Në vijim të analizës pararendëse rezultati i monitorimit tregon të njëjtat shifra me një përputhje totale të vendimit të gjykatës me mendimin e psikologut/punonjësit social të shprehur kjo dhe me % - 77.7% për vendimet përfundimtare ku gjykata i ka qëndruar besnike mendimit të psikologut/punonjësit social dhe në rastin e vendimeve të pushuara në 22.3% të tyre ndanin të njëjtin mendim.

<b>A ka trajtuar ekspertit psikolog /punonjës social në raportin e vet dhe në rekomandimet që i ka bere gjykatës nevojat që kane fëmijët për mirërritje dhe edukim?</b> <i>Po/Jo</i>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
<b>PO</b>	509	77,7%
<b>JO</b>	0	0,0%
<b>Vendime të pushuara</b>	146	22,3%

Në të gjitha vendimet përfundimtare të analizuara, eksperti psikolog /punonjës social në mendimet e dhëna gjatë vlerësimit të situatës dhe gjendjes së palëve ka ofruar rekomandime dhe vlerësime të cilat kanë patur në qendër të tyre mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës konkretisht në 77.7%. Edhe në rastin e vendimeve të pushuara, mendimet e dhëna nga psikologu/punonjësi social ka qenë në fokus të tyre interesi më i lartë i fëmijës (konkretisht në 22.3%).

## **2.2. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën/t”;**

### **2.2.1. Profili i palëve në çështjet me objekt “kërkimin e detyrimit ushqimor për fëmijët”;**

Janë monitoruar 33 vendime gjyqësore për çështjet me objekt kërkimin e detyrimit ushqimor. Në një nga çështjet është kërkuar miratimi i akt marrëveshjes. Në katër raste, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin e akteve. Në 8 nga rastet e monitoruara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes, në 7 prej të cilave, me arsyetimin

se pala paditëse nuk është paraqitur në gjykim ose ka hequr dorë nga gjykimi. Në një nga çështjet është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë.

## PALA PADITËSE

### GJINIA E PALËS PADITËSE

Gjinia		
Përshkrimi	Nr.	%
Gra	28	84.8%
Burra	5	13.5%

Nga monitorimi ka rezultuar se 84.8 % të rasteve janë gra dhe në 13.5 % të rasteve pala paditëse është grua.

### GJENDJA SOCIALE E PALËS PADITËSE

Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	11	33.3%
i/e vetëpunësuar	2	6.1%
i/e papunë	4	12.1%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	0	0.0%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 33.3 % të rasteve, pala paditëse është e punësuar, në 12.1 % të rasteve pala paditëse është i/e papunë dhe në 6.1 % të rasteve pala paditëse është i/e vetëpunësuar.

Në 6 % të rasteve pala paditëse jeton jashtë vendit në emigracion.

### MOSHA E PALËS PADITËSE

Mosha		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	9	27.3%
25-35 vjeç	12	36.4%
35-45 vjeç	4	12.1%
Tjetër	4	12.1%
Nuk ka të dhëna	4	12.1%

Nga monitorimi i çështjeve me objekt kërkimin e pensionit ushqimor rezulton se në 36.4 % të rasteve pala paditëse i përket grupmoshës 25-35 vjeç, në 27.3 % të rasteve, pala paditëse i përket grupmoshës 18-25 vjeç dhe në 12.1 % të rasteve pala paditëse i përket grupmoshës 35-45 vjeç.

## NUMRI I FËMIJËVE

NUMRI I FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
1 fëmijë	22	66.7%
2 fëmijë	4	12.1%
3 fëmijë	2	6.1%
Nuk ka të dhëna	5	15.2%

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt kërkimin e detyrimit ushqimor, ka rezultuar se në 66.7 % të rasteve pala paditëse është me 1 fëmijë, në 12.1 % të rasteve pala paditëse është me 2 fëmijë dhe në 6.1 % të rasteve pala paditëse është me 3 fëmijë.

## MOSHA E FËMIJËVE

Në lidhje me moshën e fëmijëve të palës paditëse, nga monitorimi ka rezultuar se, në 30.3 % të rasteve mosha e fëmijëve është 2-5 vjeç; në 27.3 % të rasteve mosha e fëmijëve është 6-10 vjeç, në 18.2 % të rasteve mosha e fëmijëve është 11-18 vjeç dhe në 15.1 % të rasteve mosha e fëmijëve është madhore. Një përqindje e tillë e vogël e rasteve të palëve paditëse me fëmijë madhorë është e lidhur ngushtë dhe me % e ulët që rezulton nga mosha e palës paditëse nga 35-45 vjeç ose kategoria tjetër (mbi këtë grupmoshë)

MOSHA E FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
Deri në 1 vjeç	0	0.0%
Nga 2 vjeç - 5 vjeç	10	30.3%
Nga 6 vjeç - 10 vjeç	9	27.3%
Nga 11 vjeç - 18 vjeç	6	18.2%
Nga 18 vjeç - 25 vjeç	5	15.1%
Nuk është përcaktuar mosha	9	27.3%

## ARSIMI I FËMIJËVE

Në lidhje me arsimimin e fëmijëve ka rezultuar se në 18.2 % të rasteve fëmijët vazhdojnë arsimin 9 vjeçar; në 6.1 % të rasteve fëmijët vazhdojnë arsimin parashkollor dhe në 12.1 % të rasteve fëmijët vazhdojnë arsimin e lartë. Nxjerrja e të dhënave mbi arsimin ofron më shumë detaje mbi shkaqet dhe arsyet që motivojnë dhe justifikojnë kërkesën për një detyrim ushqimor të caktuar apo për ta ndryshuar këtë detyrim në të ardhmen.

## MARRËDHËNIA E PALËS PADITËSE ME PERSONAT PËR TË CILËT KËRKOHEJ DETYRIMI USHQIMOR

Cila është marrëdhënia e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor		
Përshkrimi	Nr.	%
Prindi	24	72.7%
vetë fëmija	5	15.2%
kujdestari ligjor i fëmijës	0	0.0%
përfaqësuesi ligjor i fëmijës	0	0.0%
Tjetër	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	4	12.1%

Nga monitorimi ka rezultuar se, në 72.7 % të rasteve, marrëdhënia e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor është marrëdhënie prind fëmijë. Në 15.2 % të rasteve, pala paditëse që kërkon detyrimin ushqimor është vetë fëmija.

Në përfundim profili i palës paditëse, në çështjet me objekt kërkimin e detyrimit ushqimor është kryesisht një grua, e punësuar, që i përket grupmoshës 25-35 vjeç, prindi i fëmijës për të cilin kërkohet detyrimi ushqimor, i përfaqësuar me avokat, me një fëmijë, kryesisht të moshës 2-5 vjeç, që ndjekin arsimin 9 vjeçar.

### PALA E PADITUR

Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	10	30.3%
i/e vetëpunësuar	3	9.1%
i/e papunë	5	15.2%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	0	0.0%
në emigracion	2	6.0%
Jeton brenda vendit	13	39.4%

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “Kërkimin e detyrimit ushqimor”, ka rezultuar se, në 30.3 % të rasteve pala e paditur është e punësuar, në 15.2 % të rasteve pala e paditur është e papunë dhe në 9.1 % të rasteve pala e paditur është i/e vetëpunësuar. Të dhëna në lidhje me punësimin e palës së paditur tregojnë se kemi një % të konsiderueshme të papunë e cila sjell efekte në masën e detyrimit ushqimor të përcaktuar nga gjykata si edhe në zbatimin e vendimit të formës së prerë në lidhje me detyrimin ushqimor.

Në lidhje me vendbanimin e palës së paditur, rezultoi se në 6 % të rasteve pala e paditur është në emigracion.



Në lidhje me arsimin e palës së paditur, ka rezultuar se në 27.3 % të rasteve pala e paditur është me arsim të mesëm, në 3 % të rasteve pala e paditur është me arsim 9 vjeçar dhe në 6.1 % të rasteve pala e paditur është me arsim të lartë. Në lidhje me arsimin ka rezultuar një përqindje e lartë pa të dhëna, 63.6 %.

## MOSHA E PALËS SË PADITUR

Mosha		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	0	0.0%
25-35 vjeç	5	15.2%
35-45 vjeç	6	18.2%
Tjetër	13	39.4%
Nuk ka të dhëna	9	27.3%

Nga monitorimi ka rezultuar se në 15.2 % të rasteve mosha e palës së paditur është 25-35 vjeç, në 18.2 % të rasteve mosha e palës së paditur është 35-45 vjeç. Në 27.3 % të rasteve nuk ka të dhëna në lidhje me moshën e palës së paditur.

## PËRFAQËSIMI ME AVOKAT

### PËRFAQËSIMI I PALËS PADITËSE ME AVOKAT

<i>Është përfaqësuar pala paditëse me avokat?</i>					
Përshkrimi	Nr.	%	<i>Nëse përgjigja është po, specifikoni nëse pala paditëse është përfaqësuar nga</i>		
			Përshkrimi	Nr.	%
Po	20	60.6%	<i>Avokat nga NGO *</i>	3	15.0%
			<i>Avokat Privat</i>	17	85.0%
			<i>Avokat falas nga KSHNJ</i>	0	0%
Jo	13	39.4%			

Nga monitorimi i 33 vendimeve gjyqësore me objekt kërkimin e detyrimit ushqimor ka rezultuar se, në 60.6 % të rasteve pala paditëse është përfaqësuar me avokat dhe në 39.4 % të rasteve pala paditëse nuk është përfaqësuar me avokat. Për çështjet me këtë objekt, në 85 % të rasteve të përfaqësuara me avokat, pala paditëse është përfaqësuar me avokat privat dhe në 15 % të rasteve pala paditëse është përfaqësuar nga një avokate e një organizate jofitimprurëse, Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Nga tabela rezulton se në asnjë rast pala paditëse është përfaqësuar nga një avokat falas nga Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike.

<b>Është përfaqësuar pala e paditur me avokat?</b>					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse përgjigja është po, specifikoni nëse pala paditëse është përfaqësuar nga		
			Përshkrimi	Nr.	%
Po	8	24.2%	Avokat nga NGO	0	0%
			Avokat Privat	8	100%
			Avokat falas nga KSH-NJ	0	0%
Jo	25	75.8%			

Nga monitorimi ka rezultuar se në 75.8 % të rasteve pala paditëse nuk është përfaqësuar me avokat, vetëm në 24.2 % pala paditëse është përfaqësuar me avokat. Në të gjitha rastet e përfaqësuara me avokat, pala paditëse është përfaqësuar me avokat privat. Në asnjë nga rastet e monitoruara pala paditëse nuk është përfaqësuar me një avokat të një organizate jofitimprurëse ose me një avokat falas nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike.

## 2.2.2. Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën/t”;

### KËRKIMI NGA PALA PADITËSE E MASËS SË DETYRIMIT USHQIMOR PËR FËMIJËT.

<b>A ka kërkuar paditësi paraprakisht në kërkesë padi një masë detyrimi ushqimor për fëmijët?</b>					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po sa është shuma e kërkuar për secilën fëmijë?		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	6	18.2%	15000L/1fëmijë	2	<b>33.3%</b>
			20000L/1fëmijë	1	16.7%
			20000L/2fëmijë	1	16.7%
			25000L/2fëmijë	1	16.7%
			miratim i akt marrëveshjes	1	16.7%
<b>JO</b>	16	43.2 %			

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me këtë objekt ka rezultuar se, në 18.2 % të rasteve, pala paditëse ka kërkuar paraprakisht një masë të caktuar detyrimi ushqimor për fëmijët dhe në 43.2 % nuk është kërkuar nga pala paditëse një masë e caktuar detyrimi ushqimor për fëmijët.

Në 33.3 % të rasteve, pala paditëse ka kërkuar 15.000 lekë për një fëmijë, në 16.7 % të rasteve pala paditëse ka kërkuar 20000 lekë për një fëmijë, në 16.7 % të rasteve pala paditëse ka kërkuar 20000 lekë për dy fëmijë, në 16.7 % të rasteve pala paditëse ka kërkuar 25000

lekë për dy fëmijë dhe në një nga vendimet e monitoruara është miratuar akt marrëveshja e palëve në lidhje me masën e detyrimit ushqimor për fëmijët.

### KËRKIMI NGA PALA PADITËSE GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR E NJË MASË TË DETYRIMIT USHQIMOR.

Po gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar nga pala paditëse një shumë e caktuar?					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po sa është shuma e kërkuar gjatë shqyrtimit gjyqësor?		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	9	27.3%	12000L/1fëmijë	1	11.1%
			15000L/1fëmijë	2	22.2%
			2000L/3fëmijë	1	11.1%
			20000L/2fëmijë	1	11.1%
			400 deri ne 500 eu-ro/1fëmijë	1	11.1%
			7000L/1fëmijë	1	11.1%
			e njëjtë me kërkesë padinë	2	22.2%
<b>JO</b>	13	39.4%			

### SHUMA E CAKTUAR NGA GJYKATA SI MASË E DETYRIMIT USHQIMOR

Sa është shuma e caktuar nga gjykata për secilin nga fëmijët, si masë për detyrimin ushqimor në vendimin gjyqësor ?		
Përshkrimi	Nr.	%
20000 L/1 fëmijë	1	3.0%
7000 L/1 fëmijë	2	<b>6.1%</b>
8000L/1 fëmijë	2	<b>6.1%</b>
5000 L/1 fëmijë	1	3.0%
10000L/1 fëmijë	8	<b>24.2%</b>
10000L/2 fëmijë	1	3.0%
12000L/1 fëmijë	1	3.0%
15000L/1 fëmijë	5	<b>15.2%</b>
2000 L/3 fëmijë	1	3.0%
250euro/1 fëmijë	1	3.0%
3000L/1 fëmijë	1	3.0%
rrëzoi kërkesë padinë si të pam-bështetur në prova	1	3.0%
Vendime të pushuara	12	36.4%

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me këtë objekt, ka rezultuar se në përqindjen më të lartë të rasteve, në 24.2 % të vendimeve të monitoruara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur si masë të detyrimit ushqimor 10.000 lekë për një fëmijë; në 15.2 % të rasteve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur si masë të detyrimit ushqimor 15.000 lekë për një fëmijë, në 6.1 % të rasteve gjykata ka vendosur 7000 lekë dhe në 6.1 % të rasteve gjykata ka vendosur 8000 lekë. Pra, në mënyrë të përmbledhur, shumica e detyrimit ushqimor të vendosur nga gjykata varion midis 7000 lekë-15.000 lekë.

<b>Arsyet pse kërkohet pensioni ushqimor për fëmijët në masën e kërkuar?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
Mosha	11	33.3%
shpenzimet e rritjes së fëmijës	11	33.3%
Arsimimi	8	24.2%
shpenzime plotësuese për mirë edukimin dhe veprimtaritë extrashkollore të fëmijës	2	6.1%
probleme shëndetësore të fëmijës	1	3.0%
arsye të tjera: 1. Detyrim ushqimor simbolik 1 rast 2. Veshmbathje 1 rast 3. Nuk është shprehur mbi arsyet pse kërkohet masa e detyrimit ushqimor 4 raste 4. Rritje dhe edukim 2 raste	8	24.2%

Mosha, shpenzimet e fëmijës, arsimimi, shpenzime plotësuese për mirëdukimin dhe veprimtaritë ekstra kurrikulare, probleme shëndetësore të fëmijës janë disa nga arsyet pse kërkohet një masë e caktuar detyrimi ushqimor për fëmijët.

<b>Çfarë provash kanë paraqitur palët dhe ku mbështeten në kërkesat për detyrimin ushqimor?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
vërtetim mbi të ardhurat e palëve	9	27.3%
vërtetim nga shkolla e fëmijëve	3	9.1%
raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve	1	3.0%
vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore	1	3.0%

**Çfarë provash kanë paraqitur palët dhe ku mbështeten në kërkesat për detyrimin ushqimor?**

Përshkrimi	Nr.	%
të tjera: 1. Certifikatë 2. Dëshmi hipotekare 3. Vërtetim nga QKR për aktivitet privat 4. Kontratë pronësie dhe vërtetim nga ZRPP 5. Dokumentacion nga banka për shlyerje kredie 6. Raport mjekësor 7. Vërtetim për pension invaliditeti 8. Mundësitë ekonomike të palës së paditur 9. Kartela e punëkërkuetit nga Zyra e Punësimit Tiranë 10. Nuk ka paraqitur asnjë provë	16	48.5%

Provat kryesore të paraqitura nga palët gjyqësore mbi të cilat mbështetin kërkesat për masën e detyrimit ushqimor janë: vërtetim mbi të ardhurat e palëve, vërtetim nga shkolla e fëmijëve, raporte mbi gjendjen shëndetësore të fëmijëve ose palëve, dëshmi hipotekare, kontratë ose vërtetim pronësie nga ZRPP, kartelë punëkërkueti, vërtetim nga QKR për aktivitetet privat, etj.

**ARSYET E PARASHTRUARA NGA GJYKATA NË MBËSHTETJE TË MASËS SË DETYRIMIT USHQIMOR**

Cilat ishin arsyet e parashtruara nga gjykata për caktimin e këtij detyrimi ushqimor në masën konkrete:		
Përshkrimi	Nr.	%
Nevojat e fëmijës, specifiko	16	48.5%
mundësitë ekonomike të palës paditëse	11	33.3%
mundësitë ekonomike të palës së paditur	15	45.5%
kërkesën e palës paditëse	5	15.2%
kërkesën e palës së paditur	0	0.0%
Koha që qëndron me secilin prind	0	0.0%
Niveli i jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit.	1	3.0%
Vlerën ekonomike të punëve të shtëpisë dhe kujdesin që merr nga të dy prindërit.	0	0.0%
Shpenzimet shkollore për fëmijën	1	3.0%
Shpenzimet shkollore për fëmijën, (tarifat e detyrimit shkollor, tekstet dhe kancelaritë, etj.)	1	3.0%

Cilat ish-in arsyet e parashtruara nga gjykata për caktimin e këtij detyrimi ushqimor në masën konkrete:		
Përshkrimi	Nr.	%
Shpenzimet jashtëshkollore për fëmijën (kurse, aktivitete, si gjuhë e huaj, kurse profesionale, rrethe sportive)	0	0.0%
Banesa bashkëshortore? Përfitimi i shtëpisë bashkëshortore? (vlera e mundshme e qirasë së pronës?)	0	0.0%
të tjera 1. Minimumi i të ardhurave për frymë në vendin tonë 2. Puna informale 3. Pohimet e palëve 4. Statusi i ri familjar i palës së paditur 5. vazhdimi i shkollës 6. lindja e një fëmije tjetër nga martesja e re 7. gjendja shëndetësore e të paditurit, nevoja për mjekim të vazhdueshëm 8. Papunësia	10	30.3%
Nuk ka të dhëna	12	36.4%

Arsyet mbi të cilat gjykata është mbështetur për caktimin e masës së detyrimit ushqimor janë nevojat e fëmijëve, mundësitë ekonomike të palëve gjyqësore, kërkesa e palës paditëse, shpenzimet shkollore për fëmijën si edhe niveli i jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit. Është për t'u vlerësuar kujdesi i gjykatës mbi nivelin e jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit, me qëllim ruajtjen e këtij niveli jetese në emër të interesit më të lartë të fëmijës.

Arsye të tjera të konsideruara nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë: minimumi i të ardhurave për frymë në vendin tonë, puna informale e palëve, statusi i ri familjar i njërit prej palëve gjyqësore, lindja e një fëmije tjetër nga martesja e re, papunësia, gjendja shëndetësore e palëve, etj.

### REFERIMI I GJYKATËS NË MINIMUMIN JETIK

Nuk rezulton në vendimet gjyqësore të monitoruara që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të jetë referuar në minimumin jetik në përcaktimin e detyrimit ushqimor.

A e mban parasysh Gjykata minimumin jetik në përcaktimin e detyrimit ushqimor? <i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0.0%
<b>JO</b>	21	63.6%
Nuk ka të dhëna	12	36.4%

## DETYRIMI USHQIMOR PËR ISH BASHKËSHORTIN

A ka dhënë gjykata vendim për caktimin e një detyrimi ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike? <i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0.0%
<b>JO</b>	21	63.6%
Nuk ka të dhëna	12	36.4%

Nga monitorimi nuk kanë rezultuar vendime në të cilat gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të ketë caktuar detyrimin ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike.

## KËRKIMI I DETYRIMIT USHQIMOR NGA PALA PADITËSE PËR VETE

A ka kërkuar pala paditëse detyrim ushqimor për vete? <i>Po/Jo</i>					
Përshkrimi	Nr.	%	<b><i>Nëse po, masa e detyrimit ushqimor është rritur:</i></b>		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	1	3.0%	20000L	1	100.0%
<b>JO</b>	20	60.6%			
Nuk ka të dhëna	12	32.4%			

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore vetëm në një nga vendimet e monitoruara ka rezultuar se pala paditëse ka kërkuar detyrim ushqimor për vete. Masa e detyrimit ushqimor të kërkuar është 20.000 lekë. Duket se dispozita e Kodit të Familjes që parashikon detyrim ushqimor për ish bashkëshortin ose ish partnerin në vështirësi ekonomike nuk ka gjetur zbatimin e duhur. Nga ana tjetër, monitorimi tregon se nuk njihet nga komuniteti e drejta për detyrim ushqimor për ish bashkëshortin ose ish partnerin bashkëjetues.

## KRAHASIMI I MASËS SË DETYRIMIT USHQIMOR TË CAKTUAR NGA GJYKATA ME MASËS E DETYRIMIT USHQIMOR TË KËRKUAR NGA PALA PADITËSE.

A është masa e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata		
Përshkrimi	Nr.	%
Nuk është shprehur mbi shumën e detyrimit ushqimor	14	42.4%
e njëjtë me atë të kërkuar nga pala paditëse?	3	9.1%
më e ulët se masa e kërkuar?	4	12.1%
më e lartë se masa e kërkuar?	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	12	36.4%

Nga monitorimi ka rezultuar se, në 42.4 % të vendimeve të monitoruara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është shprehur mbi shumën e detyrimit ushqimor, në 12.1 % të vendimeve të monitoruara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar masën e detyrimit ushqimor më të ulët se masa e kërkuar dhe në 9.1 % të vendimeve të monitoruara, masa e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata është e njëjtë me masën e detyrimit ushqimor të kërkuar.

## 2.3. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor”;

### 2.3.1 Profili i palëve në çështjet me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor”;

Gjatë monitorimit të çështjeve me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor” janë marrë në shqyrtim gjithsej 37 vendime gjyqësore, nga të cilat në një prej tyre është kërkuar miratimi i akt marrëveshjes së lidhur mes palëve, në një tjetër vendim gjykata ka vendosur të kthejë aktet palëve, në një tjetër gjykata ka vendosur të ndryshojë vendimin vetëm për sa i përket të drejtës së takimit dhe në 15 çështje në të cilat gjykata ka caktuar pushimit e çështjes rezulton se në 13 prej tyre pala paditëse ka hequr dorë ose nuk është paraqitur në gjykim dhe në 2 prej tyre janë pushuar për moskompetencë dhe për rrëzim kërkesë padie.

#### PALA PADITËSE

Në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me këtë objekt rezulton që femrat përbëjnë numrin më të madh të palës paditëse me 59.5% dhe burrat me 40.5%. Kjo % na bën të mendojmë për numrin më të madh të grave (nënave) të cilave u besohet/n për rritje dhe edukim fëmija/ët.

Gjinia		
Përshkrimi	Nr.	%
Gra	22	59.5%
Burra	15	40.5%

Gjendja sociale që paraqitet gjatë monitorimit të vendimeve me objekt “Ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor” ofron një panoramë komplekse me të dhëna rreth palës paditëse ku 29.7% e tyre figurojnë të punësuar, 18.9 % të papunë dhe 2.7% të vetëpunësuar. Të tjera të dhëna tregojnë që 21.6% e totalit të palëve paditëse është me banim jashtë vendit dhe pjesa tjetër e tyre ndodhet në Shqipëri. Në këto vendime gjykata ka arsyetuar me anë të provave të paraqitura se ku ndodhen palët dhe nëse ato janë në marrëdhënie pune apo jo ose të vetëpunësuar.



Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	11	29.7%
i/e vetëpunësuar	1	2.7%
i/e papunë	7	18.9%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	2	5.4%
në emigracion	4	10.8%
Jeton brenda vendit	21	56.8%
Jeton jashtë vendit	4	10.8%
Tjetër	0	0.0%

Në rastin e të dhënave të marra mbi gjendjen arsimore të palës paditëse nga të dhënat e mbledhura rezulton se një numër i madh vendimesh nuk paraqesin të dhëna mbi gjendjen arsimore të tyre gati 62.2%, kurse nga ato vendime nga të cilat ne marrim informacion 16.2 % janë me arsim të lartë dhe po kaq me arsim të mesëm. Me një përqindje më të ulët dhe të njëjtë mes tyre janë palët paditëse me arsim fillor dhe 9 vjeçar konkretisht me 2.7% secila.

Arsimi		
Përshkrimi	Nr.	%
Fillor	1	2.7%
9 vjeçar	1	2.7%
i mesëm	6	16.2%
i lartë	6	16.2%
Nuk ka të dhëna	23	62.2%

Moshë		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	1	2.7%
25-35 vjeç	5	13.5%
35-45 vjeç	20	54.1%
Tjetër	10	27.0%
Nuk ka të dhëna	1	2.7%

Sipas të dhënave të marra rezulton se grupmosha më dominuese e palës paditëse rezulton të jetë ajo nga 35-45 vjeç me 54.1%, ndërkohë që grupmosha 25-35 vjeç janë në nivelin e 13.5%. Me një përqindje më të vogël përbëhet nga grupmosha 18-25 vjeç dhe një kategori e quajtur “Tjetër”, në të cilën nuk përfshihen grupmoshat e mësipërme, figuron të jenë me 27%. Nga ky monitorim rezulton vetëm një vendim gjyqësor i cili nuk ofron të dhëna mbi moshën e palës paditëse dhe në përqindje është rreth 2.7%.

Cila është marrëdhënia e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor		
Përshkrimi	Nr.	%
Prindi	28	75.7%
vetë fëmija	0	0.0%
kujdestari ligjor i fëmijës	0	0.0%
përfaqësuesi ligjor i fëmijës	0	0.0%
Tjetër	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	9	24.3%

Nga të dhënat e monitorimit rezulton se marrëdhënia prindërore është ajo që figuron mes palës paditëse dhe personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor, marrëdhënie e cila është në më të shumtën e rasteve me 75.7% ndërkohë që në një përqindje prej 24.3% të vendimeve ku ka dhëna figurojnë të përfshihen të gjitha ato vendime të pushimit të cilat nuk ofrojnë më shumë informacion dhe të dhëna mbi kategorinë e marrëdhënies mes palës paditëse dhe personit për të cilin kërkohet detyrimi ushqimor.

NUMRI I FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
1 fëmijë	15	40.5%
2 fëmijë	9	24.3%
3 fëmijë	3	8.1%
më shumë se tre fëmijë	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	10	27.0%

Nga të dhënat e monitorimit figuron që 40.5% e palëve paditëse kanë 1 fëmijë, 24.3% kanë 2 fëmijë dhe 8.1% 3 fëmijë. Në 27% të vendimeve nuk arrijmë të marrim asnjë informacion për shkak se vendimet e ushqimit nuk ofrojnë asnjë të dhënë specifike dhe konkrete për palët dhe gjendjen e tyre sociale.

MOSHA E FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
Deri në 1 vjeç	0	0.0%
Nga 2 vjeç - 5 vjeç	3	8.1%
Nga 6 vjeç - 10 vjeç	10	27.0%
Nga 11 vjeç - 18 vjeç	17	45.9%
Nga 18 vjeç - 25 vjeç	1	2.7%
Moshë madhore	0	0.0%
Nuk është përcaktuar moshja	16	43.2%

Nga totali i vendimeve të monitoruara ku rezultojnë palë paditëse me fëmijë, të dhënat ofrojnë që 45.9% e tyre i përkasin grupmoshës nga 11-18 vjeç, 27% grupmoshës 6-10 vjeç, 8.1% i përkasin grupmoshës 2-5 vjeç dhe 2.7% grupmoshës nga 18-25 vjeç. Një përqindje e lartë e vendimeve përbëhet nga ato ku mosha e fëmijëve nuk përcaktohet dhe kjo rreth 43.2%. Ky është element tepër i rëndësishëm për të justifikuar arsyet pse ngrihet një padi për kërkimin/ndryshimin e detyrimit ushqimor nga pala paditëse.

ARSIMIMI I FËMIJËS/VE		
Përshkrimi	Nr.	%
Arsim parashkollor	1	2.7%
vazhdon arsimin 9 vjeçar	5	13.5%
përfunduar arsimin 9vjeçar	2	5.4%
vazhdon arsimin e mesëm	2	5.4%
vazhdon arsimin e lartë	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	27	73.0%

Nga të dhënat e përfutura nga monitorimi marrim një informacion të përgjithshëm që tregon se në 13.5% të rasteve të palëve paditëse me fëmijë ata janë në vazhdim të arsimit 9 vjeçar, 5.4% e kanë përfunduar arsimin 9 vjeçar dhe 5.4% vazhdojnë arsimin e mesëm. Ndërkohë që një numër i madh vendimesh gjyqësore nuk ofrojnë të dhëna mbi gjendjen dhe nivelin arsimor të fëmijëve të palës paditëse dhe pse një element i tillë është tepër i rëndësishëm për të mbështetur kërkesën për ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor. Duke mbajtur parasysh dhe të dhënat e tabelës së mësipërme ku për % më të madhe të fëmijëve të palës paditëse nuk ka të dhëna. Kjo në raport me moshën e tyre e cila është e përshtatshme për të ndjekur arsimin 9 vjeçar dhe atë të mesëm.

Është përfaqësuar pala paditëse me avokat?					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse përgjigja është po, specifikoni nëse pala daditëse është përfaqësuar nga		
			Përshkrimi	Nr.	%
Po	25	67.6%	Avokat nga NGO	0	0%
			Avokat Privat	25	100%
			Avokat falas nga KSHNJ	0	0%
Jo	12	32.4%			

Nga të dhënat e monitorimit del që palët paditëse janë përfaqësuar me avokat gjatë proceseve me objekt "Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor" në masën 67.6% dhe nga këto raste nuk ka asnjë prej tyre që të jetë përfaqësuar nga avokatë të NGO apo nga KSHNJ por vetëm nga avokatë privatë.

Pra, profili i palës paditëse në çështjet me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor” është kryesisht një grua, e punësuar, e moshës 35-45 vjeç, me një fëmijë, e përfaqësuar me avokat.

## PALA E PADITUR

Gjendja Sociale		
Përshkrimi	Nr.	%
i/e punësuar	11	29.7%
i/e vetëpunësuar	1	2.7%
i/e papunë	0	0.0%
përfitues/e e ndihmës ekonomike	0	0.0%
në emigracion	1	2.7%
Jeton brenda vendit	15	40.5%
Jeton jashtë vendit	2	5.4%
Tjetër	7	18.9%

Nga të dhënat e marra nga monitorimi mbi gjendjen sociale të palës së paditur rezulton se 29.7 % e tyre të jenë në statusin e punësuar, dhe më pak në atë të vetëpunësuar me 2.7% ndërkohë nuk na rezultojnë të dhëna për gjendjen e palës së paditur si përfitues i ndihmës ekonomike apo statusit i papunë. Një kategori tjetër me rreth 18.9 % ka përfshirë të gjithë ato persona, palë e paditur të cilët rezultojnë të jenë në gjendje të burgosur apo në gjendje arresti, ose rezident në qendrat e drejuara nga OJF të cilët bëjnë pjesë në kategoritë e mësipërme. Nga të gjithë personat, të cilët përbëjnë palën e paditur rezultojnë se pjesa më e madhe e tyre jetojnë në Shqipëri rreth 40.5% dhe 8.1% e tyre jetojnë jashtë vendit.

Arsimi		
Përshkrimi	Nr.	%
Fillor	0	0.0%
9 vjeçar	0	0.0%
i mesëm	4	10.8%
i lartë *	3	8.1%
Nuk ka të dhëna	30	81.1%

Nga të dhënat e mbledhura për nivelin arsimor të palës së paditur rezultojnë pjesa më e madhe e vendimeve paraqesin mangësi në dhënien e të dhënave mbi këtë fakt duke përbërë dhe kategorinë më të madhe të saj me 81.1% ndërkohë që aty ku ne kemi mundur të marrim të dhëna rezulton se 10.8% janë me arsim të mesëm dhe 8.1% vazhdojnë arsimin e lartë.

Cila është marrëdhënia e palës paditëse me personat për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor		
Përshkrimi	Nr.	%
Bashkëshort	0	0.0%
Bashkëjetues	0	0.0%
Prindi	23	62.2%
vetë fëmija	0	0.0%
kujdestari ligjor i fëmijës	0	0.0%
përfaqësuesi ligjor i fëmijës	0	0.0%
Tjetër	0	0.0%
Nuk ka të dhëna	14	37.8%

Përsa i përket marrëdhënies që ekziston midis palës së paditur dhe personit për të cilin kërkohet ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor rezulton të jetë ai prindëror me 62.2%, ndërkohë që 37.8% figurojnë të mos ketë të dhëna të cilat ekzistojnë si pasojë e vendimeve të pushuara të cilat nuk japin asnjë të dhënë mbi këtë marrëdhënie.

NUMRI I FËMIJËVE		
Përshkrimi	Nr.	%
1 fëmijë	13	35,1%
2 fëmijë	7	18,9%
3 fëmijë	7	18,9%
më shumë se tre fëmijë	0	0,0%
Nuk ka të dhëna	10	27,0%

Nga monitorimi i palës së paditur rezultojnë që pjesa më e madhe e tyre kanë një fëmijë rreth 35.1%, dhe me të njëjtën **përqindje** rreth 18.9 % kanë përkatësisht dy dhe tre fëmijë. Një indikator tjetër i konsiderueshëm në këtë total numrash është 27% që përbëhet nga ato vendime të pushuara **të cilat nuk ofrojnë të dhëna nga të cilat mund të marrin ndonjë informacion të mëtejshëm.**

Moshë		
Përshkrimi	Nr.	%
18-25 vjeç	0	0,0%
25-35 vjeç	2	5,4%
35-45 vjeç	18	48,6%
Tjetër	15	40,5%
Nuk ka të dhëna	2	5,4%

Në moshë **fëmijëve** të palës paditëse përbëhet në pjesën më të madhe nga grupmosha 35-45 vjeç me 48.6%, grupmosha 25-35 vjeç përbën 5.4% dhe kategoria tjetër, e cila përfshin

kategori mbi 45 vjeç përbën 40.5% dhe për një përqindje 5.4% nuk ofrohen të dhëna gjatë monitorimit të këtyre vendimeve. Grupmosha nga 18-25 vjeç nuk ka asnjë rast të shqyrtuar nga Gjykata. Kjo të ofron mundësinë për të treguar që pala e paditur nuk ka nën përkujdesjen e tij fëmijë të mitur, **të cilët kanë nevojë për një përkujdesje monetare më specifike në krahasim me rastin nëse ata do të kishin fëmijë që ti përkisnin grupmoshës 18-25 vjeç.**

<b>Është përfaqësuar pala e paditur me avokat?</b>					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse përgjigja është po, specifikoni nëse pala paditëse është përfaqësuar nga		
			Përshkrimi	Nr.	%
Po	15	40,5%	Avokat nga NGO	0	0%
			Avokat Privat	15	100%
			Avokat falas nga KSHNJ	0	0%
Jo	22	59,5%			

Në rastin e monitorimit të përfaqësimit të palës së paditur gjatë procesit me avokat, rezulton se pjesa më e madhe e tyre nuk është e asistuar nga një avokat konkretisht me 59.5%. Ndërsa në kategorinë e palës së paditur të përfaqësuar nga një avokat që përbën 40.5% **të gjithë këta avokatë i përkasin kategorisë së avokatëve privatë.**

### 2.3.2. Gjetje të tjera nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt “ndryshimi i vendimit për masën e detyrimit ushqimor për fëmijët/t.

<b>A ka kërkuar paditësi paraprakisht në kërkesë padi një masë detyrimi ushqimor për fëmijët?</b>					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po sa është shuma e kërkuar për secilën fëmijë?		
			Përshkrimi	Nr.	%
PO	18	48,6%	10000L/1fëmijë	4	22,2%
			10000L/3fëmijë	1	5,6%
			20000L/3fëmijë	2	11,1%
			20000L/2fëmijë	2	11,1%
			30000L/1fëmijë	1	5,6%
			30000L/2fëmijë	1	5,6%
			3000L/1fëmijë	1	5,6%
			500dollarë kana-dez/2fëmijë	1	5,6%

			50000L/1fëmijë	1	5,6%
			<i>nuk ka specifikuar shumën</i>	2	11,1%
			15000L/1fëmijë	1	5,6%
			<i>miratim i akt marrëveshjes</i>	1	5,6%
<b>JO</b>	19	51,4%			

Një nga elementet të cilat janë monitoruar nga ana jonë ka qenë edhe aspekti nëse pala paditëse ka kërkuar në përmbajtjen e kërkesë padisë së saj një masë specifike për detyrimin ushqimor. Nga monitorimi rezulton se % më të lartë kanë kërkesë paditë të cilat nuk kanë të caktuar paraprakisht masën e detyrimit ushqimor, konkretisht në 51.4%. Kjo për shkaqe të ndryshme që lidhen me mos pasjen e dijenisë mbi nivelin e të ardhurave të palës tjetër apo mundësisë reale për ta provuar konkretisht me prova se ku e mbështetet kërkuesi këtë masë detyrimi. Këtu ndikon dhe mungesa e përcaktimit të një minimum jetik për secilin individ i cili do ti vinte në ndihmë argumentimit të masës së kërkuar.

Në rastin kur në kërkesë padi është përcaktuar masa e detyrimit ushqimor figuron që 22.2% e këtyre kërkuësve kanë kërkuar 10000L/1 fëmijë, të njëjtën përqindje konkretisht 5.6 % e ndajnë përkatësisht vlerat e 3000L/1 fëmijë; 30000L/1fëmijë; 50000L/1 fëmijë si 15000L/1 fëmijë. Për kërkuësit me dy fëmijë masat e detyrimit ushqimor kanë prekur shifrat e 20000L/2 fëmijë në 11.1% dhe 500 dollarë kanadez/2 fëmijë në 5.6% dhe në këtë % për masën e kërkuar në vlerën e 30000L/2 fëmijë. Në rastin kur palët kanë patur tre fëmijë masat e detyrimit ushqimor të kërkuar kanë kapur vlerat e 20000L/3fëmijë në 11.1%, 10000L/3fëmijë në 5.6%, ndërkohë që në 5.6% është zbatuar akt marrëveshja e caktuar nga palët dhe në 11.1% të vendimeve nuk është specifikuar shuma e këtij detyrimi. Nga këto të dhëna del qartë që në rastet kur palët kanë një fëmijë janë të prirura drejt detyrimeve ushqimore në masë më të lartë dhe anasjelltas.

Po gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar nga pala paditëse një shumë e caktuar?					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po sa është shuma e kërkuar gjatë shqyrtimit gjyqësor?		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>APO</b>	13	35,1%	10000L/1fëmijë	1	7,7%
			15000L/1fëmijë	2	15,4%
			20000L/2fëmijë	3	23,1%
			20000L/3fëmijë	1	7,7%
			50000L/1fëmijë	1	7,7%
			7000L/1fëmijë	1	7,7%
			7500L/1fëmijë	1	7,7%
			<i>e njejtë me kërkesë padinë</i>	3	23,1%
<b>JO</b>	24	64,9%			

Meqenëse përqindjet (%) e rasteve të monitoruara treguan konkretisht që një % e lartë e palës paditëse nuk ka kërkuar shprehimisht në kërkesë padi një masë specifike të detyrimit ushqimor, është menduar të monitorohet nëse gjatë procesit gjyqësor pala është shprehur konkretisht për këtë element. Nga monitorimi na rezulton se 64.9% e tyre edhe gjatë gjykimit nuk e ka kërkuar shprehimisht një masë konkrete për detyrimin ushqimor dhe vetëm 35.1% prej tyre e kanë kërkuar atë. Kjo % e lartë e moskërkimit ka lidhje me praktikën gjyqësore dominuese që priret ta lërë në çmim të gjykatës caktimin e masës së detyrimit për ushqim kjo edhe për faktin e pamundësisë së provimit plotësisht me prova të aftësisë paguese të palës tjetër, çështje kjo e lidhur dhe me nivelin e lartë të informalitetit në ekonominë shqiptare dhe numrit të lartë të personave që janë në emigracion. Në rastin e atyre kërkuesve që gjatë procesit kanë kërkuar një masë konkrete detyrimi ushqimor figuron që 15.4% e tyre kanë kërkuar 15000L/1fëmijë, 7.7% kanë kërkuar 10000L/1fëmijë; dhe me nga 7.7% si në rastin e 50000L/1fëmijë; për 7000L/1fëmijë dhe atë të 7500L/1fëmijë. Për dy fëmijë është kërkuar 20000L në 23.1% dhe 20000L/3fëmijë në 7.7%. Në një përqindje të lartë është dhe rasti kur palët gjatë procesit kanë deklaruar që kërkojnë një masë të detyrimit ushqimor të njëjtë me atë të kërkuar në kërkesë padi në vlerën e 23.1%.

**Sa është shuma e caktuar nga gjykata për secilin nga fëmijët, si masë për detyrimin ushqimor në vendimin gjyqësor ?**

Përshkrimi	Nr.	%
20000 L/3 fëmijë	1	2,7%
18000 L/3 fëmijë	1	2,7%
30000L/2 fëmijë	1	2,7%
5000 L/1 fëmijë	2	5,4%
15000L/1 fëmijë	1	2,7%
13000L/1 fëmijë	1	2,7%
25000L/1 fëmijë	1	2,7%
40000L/1 fëmijë	1	2,7%
13000L/2 fëmijë	1	2,7%
10000L/1 fëmijë	2	5,4%
18000L/1 fëmijë	1	2,7%
10000L/3 fëmijë	1	2,7%
17000L/3 fëmijë	1	2,7%
15000/2 fëmijë	1	2,7%
7000L/1 fëmijë	1	2,7%
6000L/1 fëmijë	1	2,7%
nuk caktoi masë për detyrimin ushqimor	1	2,7%
rrëzoi kërkesë padinë si të pambështetur në prova	1	2,7%
miratimin e akt marrëveshjes në të cilën nuk shprehet mbi masën e detyrimit ushqimor.	1	2,7%
Vendime të pushuara	18	48,6%



Duke marrë shkas nga fakti që pala paditëse ka kërkuar në kërkesën e saj një masë konkrete të detyrimit ushqimor, kemi parë të udhës të monitorojmë nëse gjykata ka qenë e prirur drejt respektimit të kësaj kërkesë dhe si kanë qenë vendimet në lidhje me pasqyrimin e këtij elementi. Nga të dhënat e marra, masa prej 5000 L/1 fëmijë dhe 10000L/1 fëmijë figurojnë në vlerën 5.4% secila ndërkohë që në një % të njëjtë prej 2.7% janë vlerat e masave të kërkuara që variojnë nga 40000L /1 Fëmijë vlera më e lartë deri në vlerën më të ulët që shkon deri në 5000L/1 fëmijë (konkretisht vlerat e caktuara nga gjykata janë: 40000L/1 fëmijë; 25000L/1 fëmijë; 13000L/1 fëmijë; 15000L/1 fëmijë; 18000L/1 fëmijë; 7000L/1 fëmijë; 6000L/1 fëmijë, 5000L/1 fëmijë).

Për rastet kur pala paditëse ka dy fëmijë masat e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata variojnë nga vlera më e madhe 30000L/2 fëmijë deri në atë më të ultën në 15000L/2 fëmijë (konkretisht 15000L/2 fëmijë; 30000L/2 fëmijë; 13000L/2 fëmijë).

Për rastet kur është caktuar masa e detyrimit për ushqim për tre fëmijë, gjykata ka caktuar vlera të tilla që shkojnë nga 10000L/3 fëmijë deri në 20000 L/3 fëmijë (konkretisht vlerat janë 17000L/3 fëmijë; 18000 L/3 fëmijë; 10000L/3 fëmijë; 20000 L/3 fëmijë)

Në të njëjtën % prej 2.7 % janë dhe rastet kur nga gjykata është miratuar akt marrëveshja e palëve të cilët nuk ishin shprehur rreth masës së detyrimit për ushqim, apo kur gjykata ka rrëzuar kërkesën si të pa mbështetur në prova apo rasti kur gjykata nuk shprehet fare për masën e detyrimit ushqimor. Nga tërësia e vendime të monitoruara doli që një % e lartë e tyre janë të pushuara nga të cilat ne nuk arrijmë të marrim një të dhënë konkrete mbi këtë element të vendimit apo edhe të kërimit gjyqësor, konkretisht në vlerën 48.6%.

<b>Arsyet pse kërkohet pensioni ushqimor për fëmijët në masën e kërkuar?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
Mosha	6	16,2%
shpenzimet e rritjes së fëmijës	8	21,6%
Arsimimi	5	13,5%
shpenzime plotësuese për mirë edukimin dhe vep- rimtaritë extrashkollore të fëmijës	0	0,0%
probleme shëndetësore të fëmijës	2	5,4%
<i>arsye të tjera:</i> 1. Mosha madhore e fëmijës 1 rast 2. Kushtet ekonomike 1 rast 3. Ushqim, zhvillim, edukim 1 rast 4. Rritje dhe edukim 1 rast	4	10,8%

Disa nga arsyet pse palët kërkojnë një masë të caktuar si detyrim ushqimor për fëmijët e tyre, sipas monitorimit tonë, rezultojnë të kenë lidhje me shpenzimet e rritjes së fëmijës, në vlerën 21.6%, moshën e fëmijës më 16.2%, arsimimin me 13.5%, problemet shëndetësore

të fëmijës me 5.4% dhe në arsye të tjera të cilat janë specifike për secilin rast të monitoruar e që përbëjnë 10.8% përfshirë:

1. Moshë madhore e fëmijës 1 rast
2. Kushtet ekonomike 1 rast
3. Ushqim, zhvillim, edukim 1 rast
4. Rritje dhe edukim 1 rast

<b>Çfarë provash kanë paraqitur palët dhe ku mbështeten në kërkesat për detyrimin ushqimor?</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
vërtetim mbi të ardhurat e palëve	5	13,5%
vërtetim nga shkolla e fëmijëve	3	8,1%
raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve	0	0,0%
vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore	0	0,0%
<i>të tjera:</i>		
<i>1. Certifikatë 1 rast</i>		
<i>2. Dëshmi hipotekore 1 rast</i>		
<i>3. Vërtetim nga QKR për aktivitet privat 1 rast</i>		
<i>4. Kontratë qiraje i paditësit 1 rast</i>		
<i>5. Vendimi gjyqësor i zgjidhjes së martesës 4 raste</i>		
<i>6. Vendimin për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore 1 rast</i>		
<i>7. Dokument miratimi para noterit gjerman 1 rast</i>		
<i>8. Aktin e vlerësimit psikologjik 1 rast</i>		
<i>9. Kartela e punëkërkuësit nga Zyra e Punësimit Tiranë 1 rast</i>		
<i>10. Mospërmbushja e detyrimit ushqimor me vërtetimin e përmbaruesit 1 rast</i>		
<i>11. Akti noterial i marrëveshjes mes dy palëve për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore 1 rast</i>		
<i>12. Njoftimet elektronike mbi vendodhjen e të paditurit 1 rast</i>		
<i>13. Vërtetim nga ILDKP 1 rast</i>		
	10	27,0%

Në tërësinë e provave të paraqitura nga palët dhe mbështetja që këto prova ofrojnë për kërkimin e masës së detyrimit ushqimor, nga monitorimi rezulton se: vërtetimi mbi të ardhurat e palëve përbën provën më të zakonshme të paraqitur gjatë hetimit gjyqësor me 13.5%, vërtetim nga shkolla e fëmijëve me 8.1% dhe në kategorinë të tjera ku përfshihen prova specifike në përputhje me karakteristikat e çështjes në shqyrtim me 27% e që përbëhen nga:

1. Certifikatë 1 rast
2. Dëshmi hipotekore 1 rast
3. Vërtetim nga QKR për aktivitet privat 1 rast
4. Kontratë qiraje i paditësit 1 rast
5. Vendimi gjyqësor i zgjidhjes së martesës 4 raste
6. Vendimin për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore 1 rast
7. Dokument miratimi para noterit gjerman 1 rast
8. Aktin e vlerësimit psikologjik 1 rast
9. Kartela e punëkërkuarit nga Zyra e Punësimit Tiranë 1 rast
10. Mospërbushja e detyrimit ushqimor me vërtetimin e përmbaruesit 1 rast
11. Akti noterial i marrëveshjes mes dy palëve për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore 1 rast
12. Njoftimet elektronike mbi vendodhjen e të paditurit 1 rast
13. Vërtetim nga ILDKP 1 rast

**Cilat ishin arsyet e parashtruara nga gjykata për caktimin e këtij detyrimi ushqimor në masën konkrete:**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
Nevojat e fëmijës, specifiko	11	29,7%
mundësitë ekonomike të palës paditëse	6	16,2%
mundësitë ekonomike të palës së paditur	6	16,2%
kërkesën e palës paditëse	2	5,4%
kërkesën e palës së paditur	0	0,0%
Koha që qëndron me secilin prind	0	0,0%
Niveli i jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit.	0	0,0%
Vlerën ekonomike të punëve të shtëpisë dhe kujdesin që merr nga të dy prindërit.	0	0,0%
Shpenzimet shkollore për fëmijën	1	2,7%
Shpenzimet shkollore për fëmijën, (tarifat e detyrimit shkollor, tekstet dhe kancelaritë, etj)	0	0,0%
Shpenzimet jashtëshkollore për fëmijën (kurse, aktivitete, si gjuhë e huaj, kurse profesionale, rrethe sportive)	0	0,0%
Banesa bashkëshortore? Përfitimi i shtëpisë bashkëshortore? (vlera e mundshme e qirasë së pronës?)	0	0,0%
të tjera	5	13,5%
Nuk ka të dhëna	18	48,6%

Një element i rëndësishëm gjatë monitorimit kanë përbërë edhe arsyet e marra në konsideratë nga gjykata për caktimin e detyrimit ushqimor në masën konkrete, pjesën më të madhe të

tyre e përbëjnë nevojat e fëmijës në masën 29.7%, e ndjekur nga mundësitë e palës paditëse dhe asaj të paditur me nga 16.2% secila, arsye të mbështetura mbi kërkesën e argumentuar nga pala paditëse me 5.4% dhe shpenzimet shkollore për fëmijën me 2.7%. Në një % të konsiderueshme janë dhe arsye të tjera të cilat kanë ndihmuar gjykatën në krijimin e bindjes së saj në proces të cilat kanë qenë specifike për rastet në shqyrtim me nga 13.5%. Duhet të themi se këto të dhëna bazohen mbi numrin total të vendimeve përfundimtare të dhëna nga gjykata pa llogaritur këto vendimet e pushuara të cilat përbëjnë 48.6% të totalit dhe ku mungojnë arsyet e gjykatës apo të dhëna të tjera kjo për shkak se hetimi gjyqësor është ndërprerë dhe nuk ka vazhduar më tej për të patur mundësi të njihemi me arsyet që do të parashtronte gjykata për caktimin e vlerës së detyrimit ushqimor.

A e mban parasysh Gjykata minimumin jetik në përcaktimin e detyrimit ushqimor? <i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0.0%
<b>JO</b>	20	54.1%
Nuk ka të dhëna	17	45.9%

Nga tërësia e vendimeve përfundimtare me objekt “Caktimin e masës së detyrimit ushqimor”, është vënë re që në asnjë prej tyre nuk është marrë parasysh nga gjykata minimumi jetik në caktimin e masës së detyrimit ushqimor për fëmijët, kjo në 54.1%. Pjesa tjetër prej 45.9% i përket vendimeve që rezultojnë të pushuara dhe që nuk ofrojnë të dhëna ilustruese për këtë kërkesë tonën. Fakti që asnjë nga vendimet nuk e ka thirrur apo evidentuar domosdoshmërinë e marrjes si etalon për ta respektuar nivelin e minimumit jetik mbi të cilin do të mbështetej vendimi i saj në caktimin e masës së detyrimit ushqimor lidhet me faktin se mungojnë të dhëna/vlerësime që të tregojnë se si llogaritet ky nivel apo mungon praktika ligjore që të jetë kërkuar përllogaritja e tij gjatë një procesi ligjor me këtë objekt.

A ka dhënë gjykata vendim për caktimin e një detyrimi ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike? <i>Po/Jo</i>		
Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0.0%
<b>JO</b>	20	54.1%
Nuk ka të dhëna	17	45.9%

Një tjetër pikë me interes në monitorimin tonë ishte dhe praktika e caktimit të detyrimit ushqimor për ish bashkëshortin apo ish partnerin në vështirësi ekonomike se në sa raste të tilla gjykata ka vendosur në favor të dhënies së këtij detyrimi. Nga monitorimi ynë del se në asnjë rast gjykata nuk ka caktuar një masë detyrimi ushqimor për ish bashkëshortin apo partnerin, kjo e lidhur ngushtë me rastet e kërkimit të këtij detyrimi prej vetë atyre si në kërkesë padi ashtu dhe gjatë procesit, raste këto të pakta në numër ose inekzistente.

A ka kërkuar pala paditëse detyrim ushqimor për vete? Po/Jo					
Përshkrimi	Nr.	%	Nëse po, masa e detyrimit ushqimor është rritur:		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0.0%			
<b>JO</b>	20	54.1%			
Nuk ka të dhëna	17	45.9%			

Gjatë monitorimit doli që në të gjitha çështjet e përfunduara, konkretisht 54.1% të tyre, në asnjërin prej tyre pala paditëse nuk ka kërkuar një detyrim ushqimor për vete, kërkesë kjo e cila ka bazë ligjore në Nenin 161 Kodi i Familjes. Në pjesën tjetër të vendimeve të monitoruara nuk arrihet të kemi një përfundim pasi nuk ka të dhëna nga të cilat mund të arrihet në një deduksion të tillë<sup>29</sup>.

A është masa e detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata		
Përshkrimi	Nr.	%
Nuk është shprehur mbi shumën e detyrimit ushqimor	4	10.8%
e njëjtë me atë të kërkuar nga pala paditëse?	1	2.7%
më e ulët se masa e kërkuar?	9	24.3%
më e lartë se masa e kërkuar?	5	13.5%
Nuk ka të dhëna	18	48.6%

Në rastin e monitorimit të masës së detyrimit ushqimor të caktuar nga gjykata, gjetjet ofrojnë që në më të shumtën e rasteve prirja ka qenë drejt caktimit të një masë detyrimi ushqimor më të ulët se ajo e kërkuar nga pala paditëse me 24.3%, më të lartë me 13.5% dhe në 10.8% gjykata nuk është shprehur për masën e detyrimit ushqimor për të miturin. Vetëm në 2.7% të këtyre rasteve vendimi i gjykatës përsa i përket masës së detyrimit ushqimor është e njëjtë me atë të kërkuar nga pala paditëse<sup>30</sup>.

Në rastin e kërkesës për ndryshim vendimi mbi masën e pensionit ushqimor cilat janë arsyet pse kërkohet ky ndryshim nga palët:		
Përshkrimi	Nr.	%
gjendja ekonomike e prindit që ka detyrimin për rritje dhe edukim të fëmijës	4	10,8%
gjendja ekonomike e prindit të cilit i njihet detyrimi për të paguar	7	18,9%
nevoja dhe domosdoshmëria për një ndryshim të masës së detyrimit për të përballuar shpenzimet jetësore / mjekësore të fëmijës	6	16,2%

29 Këto janë vendimi pushimi nga të cilat gjykata nuk ofron asnjë të dhënë më shumë (45.9%).

30 Të dhënat i referohen të gjitha vendimeve nga të cilat nxirret informacion dhe këto përbëjnë 51.3%, ndërsa pjesa tjetër 48.6% janë totali i vendimeve nga të cilat nuk nxirret informacion.

**Në rastin e kërkesës për ndryshim vendimi mbi masën e pensionit ushqimor cilat janë arsyt pse kërkohet ky ndryshim nga palët:**

Përshkrimi	Nr.	%
nevoja dhe domosdoshmëria për një ndryshim të masës së detyrimit për të përballuar shpenzimet për arsimimin e fëmijës	2	5,4%
arsye të tjera 1. mirëritje dhe edukim 2. probleme shëndetësore të fëmijës 3. mosha 4. edukim 5. zhvillim 6. arsimim 7. kostoja e jetesës e cila ka ndryshuar nga 2001 që vendimi për detyrimin ushqimor kishte marr formë të prerë	4	10,8%
Nuk ka të dhëna	18	48,6%

Gjatë monitorimit të vendimeve rezulton se arsyt që palët kanë parashtruar në kërkesën e tyre për ndryshim vendimi mbi masën e pensionit ushqimor janë bazuar më së shumti në gjendjen ekonomike të prindit të cilit i njihet detyrimi për të paguar – me 18.9%; tek nevoja dhe domosdoshmëria për një ndryshim të masës së detyrimit për të përballuar shpenzimet jetësore / mjekësore të fëmijës – me 16.2%; në gjendjen ekonomike të prindit që ka detyrimin për rritje dhe edukim të fëmijës – me 10.8%. Arsye të tjera si: 1. mirëritje dhe edukim, 2. probleme shëndetësore të fëmijës, 3. mosha, 4. edukim, 5. zhvillim, 6. arsimim, 7. Kostoja e jetesës e cila ka ndryshuar nga 2001 që vendimi për detyrimin ushqimor kishte marrë formë të prerë, janë më të pakta me 10.8% dhe nevoja dhe domosdoshmëria për një ndryshim të masës së detyrimit për të përballuar shpenzimet për arsimimin e fëmijës – me 5.4%. Një përqindje të ndjeshme zënë vendimet të cilat nuk ofrojnë të dhëna mbi shkaqet dhe arsyt që shtynë palët për të kërkuar masën e detyrimit ushqimor me 48.6 %, kjo ndoshta ngaqë mendohet të parashtrohet gjatë shqyrtimit gjyqësor nga palët.

**A është dëgjuar në seancë mendimi i ekspertit psikolog /punonjës social në dhënien e vendimit të gjykatës?**

*Po/Jo*

Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0%
<b>JO</b>	20	54,1%
<b>Vendime te pushuara</b>	17	45,9%

**A është konkluzioni i ekspertit të çështjes i njëjtë me atë të gjykatës?**

*Po/Jo*

Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	0	0,0%
<b>JO</b>	20	54,1%
<b>Vendime te pushuara</b>	17	45,9%

**A ka trajtuar ekspertit psikolog /punonjës social në raportin e vet dhe në rekomandimet që i ka bërë gjykatës nevojat që kane fëmijët për mirëritje dhe edukim?**

*Po/Jo*

<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
<b>PO</b>	0	0,0%
<b>JO</b>	20	54,1%
<b>Vendime të pushuara</b>	17	45,9%

Gjatë monitorimit të vendimeve gjyqësore me objekt “Ndryshimin e detyrimit ushqimor” rezultoi se gjykata ka bërë pjesë të saj në gjykim mendimin e psikologut/punonjësit social duke e thirrur atë në 45.9 % të vendimeve të cilat më tej rezultojnë të pushuara nga palët. Pjesa tjetër e vendimeve, e cila është dhe ajo më konsistentja, paraqet një mungesë të pranisë së ekspertit në masën 54.1 %. Në të njëjtat nivele qëndron edhe rasti nëse gjykata ka dhënë një vendim të njëjtë me atë të ekspertit dhe kjo është 54.1 % duke deduktuar që një mungesë e pjesëmarrjes së psikologut në proces nuk garanton një mbrojtje korrekte të interesit më të lartë të fëmijës dhe një vendim gjyqësor të bazuar mbi një vlerësim real dhe korrekt siç është rasti i mendimit të ekspertit psikolog a punonjës social. Në rastin e vendimeve të pushuara ato paraqesin të njëjtat % konkretisht, në të gjitha rastet gjykata ka ndarë të njëjtin mendim me ekspertin dhe ka mbajtur parasysh në aktin e tij të ekspertimit nevojat dhe interesin e fëmijës për rritje dhe edukim me 45.9% në secilin rast.

**Çfarë provash kanë paraqitur palët dhe ku mbështeten në kërkesat për ndryshimin e detyrimit ushqimor?**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
vërtetim mbi të ardhurat e palëve	9	24,3%
vërtetim nga shkolla e fëmijëve	2	5,4%
raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve;	1	2,7%
vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore;	1	2,7%
të tjera 1. Vërtetim nga QKR për aktivitet privat 2. kontratë qiraje e paditësit 3. vendimi gjyqësor mbi zgjidhjen e martesës 4. njoftime elektronike për vendndodhjen 5. punën 6. studimet e të paditurit 7. pretendimet e palës së paditur mbi kushtet ekonomike 8. asistencë ekonomike 9. dokument që ka marrë kredi 10. ILDKP 11. Kartela e punëkërkuarit nga Zyra e Punësimit Tiranë 12. mospërmbushja e detyrimit ushqimor me vërtetimin e përmbartësit 13. Vendimi gjyqësor për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore 14. dokument miratimi para noterit gjerman	14	37,8%
Nuk ka të dhëna	18	48,6%



Gjatë monitorimit kanë dalë që provat të cilat janë paraqitur nga palët gjatë gjykimit më së shumti kanë konsistuar në kategorinë e të tjera ku specifikisht kanë qenë:

1. Vërtetim nga QKR për aktivitet privat
2. Kontratë qiraje e paditësit
3. Vendimi gjyqësor mbi zgjidhjen e martesës
4. Njoftime elektronike për vendndodhjen
5. Punën
6. Studimet e të paditurit
7. Pretendimet e palës së paditur mbi kushtet ekonomike
8. Asistencë ekonomike
9. Dokument që ka marrë kredi
10. ILDKP
11. Kartela e punëkërkuesit nga Zyra e Punësimit Tiranë
12. Mospërmbushja e detyrimit ushqimor me vërtetimin e përmbaruesit
13. Vendimi gjyqësor për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore
14. Dokument miratimi para noterit gjerman.

Kjo kategori përfshin 37.8% të tërësisë së provave e ndjekur me 24.3% që përbëhen nga vërtetimet e të ardhurave të paraqitura nga palët, vërtetimi nga shkolla e fëmijëve me 5.4% dhe raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve dhe, vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore me nga 2.7 % secili. Bie në sy një % e lartë e kategorisë pa të dhëna me 48.6% e cila tregon që vendimet nuk japin asnjë informacion mbi provat e sjella nga palët gjatë shqyrtimit gjyqësor gjë që ndikon dhe në cilësinë e vendimit dhe arsytimit të tij.

<b><i>Në çështjet gjyqësore me objekt "Ndryshimin e vendimit", gjykata ka ndryshuar masën e detyrimit ushqimor</i></b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>%</b>
për të gjithë fëmijët	11	29,7%
vetëm për njërin	2	5,4%
për disa prej tyre	0	0,0%
Nuk ka të dhëna	16	43,2%

Gjykata në rastet e çështjeve gjyqësore me objekt "Ndryshimin e vendimit të detyrimit ushqimor", kanë ndryshuar masën e detyrimit ushqimor për të gjithë fëmijët me 29.7% dhe me 5.4% vetëm për njërin prej tyre. Gjithashtu rreth 43.2% e vendimeve gjyqësore nuk ofrojnë të dhëna mbi këtë kërkesë. Gjatë këtij monitorimi u evidentua që, në 1 rast gjykata ka caktuar uljen e masës së detyrimit ushqimor, në një rast ky detyrim është hequr, në 7 raste gjykata nuk e ka ndryshuar masën e detyrimit ushqimor dhe në një rast ka miratuar akt marrëveshjen e lidhur midis palëve.



**A ka vendosur gjykata të ndryshojë masën e detyrimit ushqimor?**

*Po/Jo*

Përshkrimi	Nr.	%	<b>Nëse po, masa e detyrimit ushqimor është rritur:</b>		
			Përshkrimi	Nr.	%
<b>PO</b>	13	35,1%	<i>për të gjithë fëmijët</i>	11	84,6%
			<i>vetëm për njërin</i>	2	15,4%
			<i>për disa prej tyre</i>	0	0,0%
<b>JO</b>	8	21,6%	<b>Nëse jo, masa e detyrimit ka mbetur e njëjtë</b>		
			Përshkrimi	Nr.	%
			<i>për të gjithë fëmijët</i>	8	133,3%
			<i>vetëm për njërin</i>	0	0,0%
			<i>për disa prej tyre</i>	0	0,0%

Në vijim të logjikës së mësipërme gjykata në rastet e kërkesës për ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor i është përgjigjur pozitivisht asaj me 35.1% duke caktuar rritjen e masës për të gjithë fëmijët në 84.6%, dhe vetëm për njërin prej tyre me 15.4%. Në rastin e përgjigjes negative të gjykatës ndaj ndryshimit të masës së detyrimit ushqimor kjo ka prekur nivelin e 21.6 % duke mbetur e pandryshuar konkretisht për të gjithë fëmijët në nivelet e 133.3%.

**Arsyet ku është mbështetur gjykata në ndryshimin e vendimit të saj**

Përshkrimi	Nr.	%
Gjendja ekonomike e palës paditëse	7	18,9%
Gjendja ekonomike e palës së paditur	9	24,3%
Mosha e fëmijëve	9	24,3%
Arsimimi i fëmijës/ve	9	24,3%
Gjendja shëndetësore e fëmijëve	2	5,4%
Gjendja shëndetësore e palës së paditur	0	0,0%
Gjendja shëndetësore e palës paditëse	0	0,0%
Mirërritja e fëmijës/ve	9	24,3%
Ndryshimi i kushteve sociale të palës paditëse	3	8,1%
Ndryshimi i kushteve sociale të palës së paditur	4	10,8%

**Arsyet ku është mbështetur gjykata në ndryshimin e vendimit të saj**

Përshkrimi	Nr.	%
Shkaqe të tjera 1. Gjykata mban parasysh elementë të tillë si raportin ndërmjet minimumit jetik dhe rritjen e kërkesave në kushtet e rritjes së inflacionit dhe ndryshimit të ndjeshëm në rritjen e çmimeve e standardeve të jetesës. 2. Gjykata gjithashtu mban në konsideratë jo vetëm pagën por edhe gjendjen e llogarive bankare në emër të paditësit. 3. Edukimi dhe zhvillimi i fëmijës 4. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore është ndarë midis dy prindërve për të 2 fëmijët. Në këtë rast meqenëse secili prind ka në ngarkim nga një fëmijë nuk e shikon të arsyeshme të caktojë masë për detyrimin ushqimor 5. moshë aktive për punë e palës së paditur, gëzon shëndet të plotë, dhe ka parasysh gjithashtu koston e lartë që kërkon rritja dhe edukimi i një fëmije 6. Familja e re e të paditurit, bashkëshortja aktuale është e papunë dhe kanë një fëmijë të mitur 7. Marrëveshje ndërmjet palëve	6	16,2%
Nuk ka të dhëna	18	48,6%

Arsyet se ku është mbështetur gjykata në dhënien e këtij vendimi kanë qenë të lidhura me shumë arsye si: Gjendja ekonomike e palës së paditur; Moshë e fëmijëve; Arsimimi i fëmijës/ve; Mirërritja e fëmijës/ve me nga 24.5% secila. Gjendja ekonomike e palës paditëse me 18.9%; Ndryshimi i kushteve sociale të palës së paditur me 10.8%; Ndryshimi i kushteve sociale të palës paditëse me 8.1%; Gjendja shëndetësore e fëmijëve me 5.4%. Ndër të tjera shkaqe të cilat kanë qenë konkrete për raste specifike prekin nivelin e rreth 16.2% duke përfshirë këto arsye:

1. Gjykata mban parasysh elementë të tillë si raportin ndërmjet minimumit jetik dhe rritjen e kërkesave në kushtet e rritjes së inflacionit dhe ndryshimit të ndjeshëm në rritjen e çmimeve e standardeve të jetesës.
2. Gjykata gjithashtu mban në konsideratë jo vetëm pagën por edhe gjendjen e llogarive bankare në emër të paditësit.
3. Edukimi dhe zhvillimi i fëmijës.
4. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore është ndarë midis dy prindërve për të 2 fëmijët. Në këtë rast meqenëse secili prind ka në ngarkim nga një fëmijë nuk e shikon të arsyeshme të caktojë masë për detyrimin ushqimor.
5. Moshë aktive për punë e palës së paditur, gëzon shëndet të plotë duke patur parasysh gjithashtu edhe koston e lartë që kërkon rritja dhe edukimi i një fëmije.
6. Familja e re e të paditurit ku bashkëshortja aktuale është e papunë dhe pasja e një fëmije të mitur.
7. Marrëveshja ndërmjet palëve.

Një % të lartë rreth 48.6% zë edhe opsioni pa të dhëna, gjë që tregon sërish që nga vendimi nuk arrijmë të marrim asnjë të dhënë mbi provat e paraqitura nga palët që të vërtetonin, mbështetnin e argumentonin kërkesën e tyre për të ndryshuar apo jo masën e detyrimit ushqimor.

## 2.4. Konkluzione dhe Rekomandime

### KONKLUZIONE:

- Profili i palës paditëse në çështjet me objekt “Zgjidhjen e martesës” dhe rregullimin e pasojave të saj është kryesisht një grua, e punësuar, që jeton brenda vendit, me arsim të mesëm, e cila i përket grupmoshës 35-45 vjeç, me një fëmijë të moshës 11-18 vjeç, e që kërkon detyrimin ushqimor për fëmijët.
- Profili i palës paditëse në çështjet me objekt “Kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën/t” është kryesisht një grua, e punësuar, që i përket grupmoshës 25-35 vjeç, prindi i fëmijës për të cilin kërkohet detyrimi ushqimor, i përfaqësuar me avokat, me një fëmijë, kryesisht të moshës 2-5 vjeç, që ndjek arsimin 9 vjeçar.
- Profili i palës paditëse në çështjet me objekt “Ndryshimin e masës së detyrimit ushqimor” është kryesisht një grua, e punësuar, e moshës 35-45 vjeç, me një fëmijë, e përfaqësuar me avokat.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimet e saj është referuar në Konventat Ndërkombëtare<sup>31</sup> që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe interesin më të lartë të tyre. Ka rezultuar se gjyqtarët ju referohen konventave mbi të drejtat e fëmijëve, të ratifikuara nga shteti shqiptar por referenca e tyre në këto akte ndërkombëtare është lidhur vetëm me lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim dhe nuk rezulton të jetë argumentuar referimi në këto akte lidhur me të drejtën e fëmijës për të përfituar detyrimin ushqimor ndaj prindit debitor.
- Ndihma ligjore falas e ofruar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike nuk garantohet si duhet për grupet në nevojë që i drejtohen gjykatës në rastet ligjore me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, ndër të cilat edhe caktimin e detyrimit ushqimor për fëmijët.
- Konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i kushton një vëmendje të veçantë në arsyetimin e vendimit pjesës që lidhet me lënien e fëmijës në rritje dhe edukim se cilit prind por, nuk i kushton të njëjtën vëmendje lidhjes midis caktimit të masës së detyrimit ushqimor dhe interesit më të lartë të fëmijëve.
- Nuk mungojnë rastet kur vendimi për caktimin e masës së detyrimit ushqimor merret në mungesë të palës së paditur dhe pa patur prova të mjaftueshme për të caktuar masën e këtij detyrimi.
- Kërkimi i detyrimit ushqimor në një masë të caktuar nga pala paditëse është lidhur me shpenzimet e rritjes së fëmijës, moshën, arsimin, nevojat shëndetësore, etj. Gjykata ka bazuar vendimin e saj në nevojat e fëmijës për veshje, ushqim dhe arsimim, mundësitë ekonomike të palës paditëse, mundësitë ekonomike të palës së paditur si

31 Shih vendimet nr.2876, datë 28.02.2014; nr.2985, datë 03.03.2014; nr.3930, datë 11.03.2014, nr.4181, datë 01.04.2014; nr.2541, datë 24.02.2014; nr.2225, datë 17.02.2014; nr.2226, datë 17.02.2014; nr.1956, datë 11.02.2014; nr.1880, datë 10.02.2014; nr.896, datë 27.01.2014; nr.3050, datë 04.03.2014; nr.3010, datë 04.03.2014; nr.3009, datë 04.03.2014; nr.2958, datë 03.03.2014; nr.144, datë 15.01.2014; nr.424, datë 20.01.2014; nr.6282, datë 28.05.2014; nr.951, datë 27.01.2014; nr.1863, datë 10.02.2014; nr.1877, datë 10.02.2014; nr.1919, datë 10.02.2014; nr.2104, datë 13.02.2014; nr.2155, datë 13.02.2014; nr.2168, datë 14.02.2014; nr.4465, datë 07.04.2015; nr.869, datë 27.02.2014;

edhe nivelin e jetesës së fëmijës gjatë kohës që qëndronte me të dy prindërit. Gjykata ka dhënë vendimin e saj në lidhje me detyrimin ushqimor duke u mbështetur në provat e mëposhtme si: vërtetimi mbi të ardhurat e palëve, vërtetimin nga shkolla e fëmijëve, raporte mbi gjendjen shëndetësore të palëve ose fëmijëve, vërtetim në lidhje me ndjekjen e veprimtarive jashtëshkollore si edhe dokumente të tjera të konsideruara me rëndësi si Certifikata, Dëshmi hipotekore, Marrëveshje, Kredi dhe vendime të lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose të Urdhrit të Mbrojtjes.

- Ndonëse neni 162 i Kodit të Familjes parashikon se, *“Me kërkesën e njërit prej ish bashkëshortëve, punëdhënësi, organet financiare përkatëse, zyrat e tatimeve dhe çdo organ tjetër ku mund të merren prova, janë të detyruar të japin gjithë informacionin e nevojshëm për gjendjen pasurore të ish bashkëshortit tjetër dhe për të gjitha të ardhurat e tjera të tij”*, ka mungesë informacioni në lidhje me këtë të drejtë.
- Ka rezultuar një numër i kufizuar rastesh kur pala paditëse kërkon edhe detyrim ushqimor për vete ose kontribut kompensues si pasojë e pabarazive të krijuara nga zgjidhja e martesës.

## SUGJERIME:

- Sugjerohet referimi në aktet ndërkombëtare dhe praktikën e GJEDNJ ose mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë jo vetëm në lidhje me lënien e fëmijës për rritje dhe edukim një prindi dhe të drejtën e takimit por edhe në lidhje me caktimin e detyrimit ushqimor duke e konsideruar edhe këtë element si mjaft të rëndësishëm dhe të lidhur ngushtë me interesin më të lartë të fëmijës.
- Rekomandohet përmirësimi i arsytimit nga ana e gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore në lidhje me caktimin e masës së detyrimit ushqimor dhe mbështetjen e vendimit në prova. Rekomandohet organizimi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarët, në lidhje me arsytimin e vendimeve për caktimin e detyrimit ushqimor dhe çështjen e interesit më të lartë të fëmijës;
- Rekomandohet rritja e nivelit të informacionit të komunitetit mbi të drejtën për shërbim ligjor falas, kërkimin e detyrimit ushqimor jo vetëm për fëmijët por edhe për bashkëshortin, të drejtën e kontributit kompensues, etj.
- Rekomandohet përcaktimi në Kodin e Familjes i një kufiri minimal dhe maksimal të përcaktimit të detyrimit ushqimor referuar në pagën minimale, në të ardhurat personale dhe familjare, pasurinë, etj.
- Rekomandohet rritja e nivelit të informacionit të komunitetit mbi të drejtat e parashikuara në Kodin e Familjes në lidhje me detyrimin për ushqim për fëmijën dhe ish bashkëshortin.

## 3. Analiza e një rasti konkret

### Përmbledhje e çështjes R.G.

- **Procedurat Gjyqësore dhe përmbartimore**

**R. G.** ka zgjidhur martesën ligjore me vendimin nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Gjykata ka vendosur lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur A.A., i dtl. 24.5.1998 dhe M.A., e dtl. 20.5.2000 nënës së tyre R.G. Paditësi G.A. të paguajë një kontribut ushqimor për fëmijët A.A. dhe M.A. në shumën prej 1000 lekë në muaj për secilin fëmijë. Me vendimin nr. 125, datë 28.9.2001, Gjykata e Shkallës së parë Librazhd ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 148, datë 16.5.2001.

Në datën 28.9.2001, qytetarja R.G i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit Librazhd për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Zyra e Përmbartimit Librazhd po në këtë datë, më 28.9.2001 ka filluar zyrtarisht procedurat e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor. Konkretisht, me dokumentin Nr. 299 Prot., datë 28.9.2001, zyra e përmbartimit Librazhd i është drejtuar debitorit G.A. me qëllim likuidimin në mënyrë vullnetare të detyrimit ushqimor për fëmijët.

Në datën 4.10.2002 në zbatim të vendimit gjyqësor nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, përmbartuesi gjyqësor vendosi të bëjë sekuestrimin e pasurisë së debitorit G.A në banesën e ndodhur në fshatin Kuturman, Librazhd. Nga procesverbali i përmbartuesit gjyqësor rezulton se në banesën e debitorit nuk ndodhet asnjë person prej disa muajsh, pasi ndodhen në Greqi. Këtë fakt e konfirmon dhe kryeplaku i fshatit Rr.K. Për këtë shkak, përmbartuesi nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me pasurinë e debitorit.

Më tej, bazuar në procesverbalet e përmbartuesve gjyqësorë dhe mbi deklaratën e vet R.G-së rezulton se debitori G.A ka paguar detyrimin ushqimor në favor të fëmijëve të mitur deri në muajin qershor 2006.

Ndërkohë, R.G ka kërkuar ndryshimin e vendimin nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd për rritjen e masës së detyrimit ushqimor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.2594, datë 7.11.2008 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, duke detyruar të paditurin G.A të paguajë në favor të fëmijës A.A shumën prej 4500 lekë në muaj dhe për fëmijën M.A shumën prej 3500 lekë në muaj”.

Në vitin 2011, R.G ka kërkuar përsëri rritjen e masës së detyrimit ushqimor dhe ndryshimin e vendimit nr. 148, datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 1197 (2560), datë 25.5.2011 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 148 datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, duke detyruar të paditurin G.A. të paguajë në favor të fëmijës A.A. shumën prej 6000 lekë në muaj dhe për fëmijën M.A. shumën prej 5000 lekë në muaj”.

Për të dyja vendimet e mësipërme, Gjykata ka lëshuar urdhrat e ekzekutimit dhe R.G. i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Librazhd dhe Elbasan për të ekzekutuar këto vendime gjyqësore.

Sipas dokumentit Nr. 221Regj., 30.03.2012, Zyra e Përmbarrimit Elbasan vërteton se debitori G.A. ka paguar detyrimin ushqimor për dy fëmijët e mitur deri në muajin qershor 2006. Ajo sqaron se vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar, pasi debitori ndodhet në emigracion në shtetin Grek dhe se nuk ka pasuri të sekuestrueshme. Sipas dokumentit të lëshuar nga Zyra e Përmbarrimit Elbasan nr. 704 Regj, datë 1.10.2013 vërtetohet se detyrimi nuk është paguar rregullisht dhe për pasojë deri në datën 30.9.2013 mbeten pa paguar 622.000 lekë.

R.G. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar sipas objektit më poshtë vijon;

“Konstatimin e cenimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit nr. 148, datë 16.05.2001 të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, i ndryshuar, me vendimin nr. 2594, datë 07.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe me vendimin nr. 1197, datë 25.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; Detyrimin e Zyrës së Përmbarrimit Elbasan për zbatimin e menjëhershëm të vendimit, si dhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror në sasinë e vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me anë të ekspertëve kontabël.”

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 datë 21.04.2014 ka rrëzuar kërkesën e R.G.

R.G. i është drejtuar me mbështetjen e Qendrës, Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Tetor 2014 dhe ka kërkuar nga kjo Gjykatë që të konstatojë cenimin e nenit 6, nenit 8 dhe nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata ka vendosur mos pranimin e kërkesës së R.G për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë.

R.G. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesën me objekt, “Njohja dhe zbatimi i vendimit të formës së prerë nr. 148 datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, “Për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve”; i vendimit të formës së prerë nr. 2594 datë 7.11.2008, i Gjykatës së Shkallës së I-rë Elbasan “Për ndryshimin e vendimit nr. 148 datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd” dhe i vendimit të formës së prerë nr. 1197 (2560) datë 25.5.2011, i Gjykatës së Shkallës së I-rë Elbasan, “Për ndryshimin e vendimit nr. 148 datë 16.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd”, në Republikën e Greqisë.” Në zbatim të Konventave të ratifikuara nga shteti shqiptar, Ligj nr. 7760, date 14.10.1993, Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale”, Nenet 3, 23, 26, 27; Ligj Nr. 9554, datë 8.6.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për njoftimin dhe

*dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”, neni 2 i ligjit dhe neni 6 i Konventës; Gjykata e ka pushuar gjykimin.*

## Vendimet penale

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 263, datë 10.5.2012 në mungese ka gjykuar dhe dënuar G.A. me 6 muaj burg për mosdhënien e mjeteve për jetesë parashikuar nga neni 125 të K. Penal.

G.A. ka kërkuar rivendosje në afat për të ankimuar vendimin penal dhe gjykata ka pranuar kërkesën.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-1834(61), datë 14.05.2014, ka vendosur prishjen e vendimit penal nr. 263(13-2012-3324), datë 10.5.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pushimin e çështjes në ngarkim të akuzuarit G.A. për shkak të amnistisë.

Në datën 28.04.2014, R.G. ka bërë kërkesë tjetër penale, në gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan për mosdhënie të mjeteve për jetesë në bazë të nenit 125 të K. penal.

## Çështjet administrative

Me dokumentin nr. 7528/1. Prot./I.H, datë 07.09.2010 rezulton se Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje kërkesës së avokatit të R.G. se për të vënë në ekzekutim vendimin për detyrimin ushqimor duhet të zbatohen kërkesat e Konventës së Hagës dhe në këto kushte nëpërmjet kësaj shkrese Ministria e Drejtësisë si autoritet qendror për zbatimin e kësaj konvente sqaron se qytetarja R.G. duhet ti drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

R.G. i është drejtuar dy here Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Komisioni me Shkresën nr. 160/1 Prot., Datë 12.12.2012 ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit **(rreth 12 dokumente) në një afat 15 ditor, me qëllim shqyrtimin e kërkesës.**

Me Shkresën nr. 84/1, datë 20.06.2013, Komisioni shtetëror i ndihmës juridike i është përgjigjur R.G. se në lidhje me marrjen e një vendimi mbi kërkesën e saj nevojitet përgatitja e akteve nënligjore.

R.G. për ekzekutimin e vendimit i është drejtuar 2 herë Ministrit të Brendshëm. Ajo i është drejtuar gjithashtu Ambasadës shqiptare në Greqi, Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan, Presidentit, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryeministrit, Ministrit Veliaj.



## 4.

# Çështje të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve në rastet e zgjidhjes së martesës.

Nga monitorimi i disa praktikave të zhvilluara nga avokatet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)<sup>32</sup> janë evidentuar raste që dëshmojnë një mos efektivitet të dukshëm nga organet përkatëse në këtë veprimtari. Vërejmë se ky fakt nuk është në vëmendjen e duhur nga institucionet që kanë për detyrë të zbatojnë këto vendime, ose të kontrollojnë zbatimin e tyre. Jurisprudenca gjyqësore, veçanërisht ajo Kushtetuese, kanë detyra të rëndësishme në këtë aspekt. Prandaj, është e nevojshme që përmes këtij punimi të nxjerrim mësim për përmirësimin e mekanizmave institucionalë, me qëllim zbatimin e kësaj kategorie të vendimeve gjyqësore.

### 1. **Vështrim i përgjithshëm i efektshmërisë së organeve kompetente në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave statistikore.**

Sa herë që analizojmë situatën e vështirë ekonomike të nënave pas zgjidhjes së martesës, ose të nënave të pamartuara, një nga problemet që evidentohet qartazi është pafuqia e tyre ekonomike. Kështu, midis të tjerave, lind nevoja të hulumtojmë përmbushjen e detyrimit për ushqim për fëmijët nga prindi debitor, si një çështje e rëndësishme për të siguruar ushqimin dhe mirërritjen e tyre. *“Prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për fëmijën kanë përgjegjësinë parësore për të siguruar, brenda mundësive dhe mjeteve financiare, kushtet e*

32 Për më tej shih: Raport “Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë tënë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj”. Periudha janar-dhjetor 2014, realizuar nga Qendra për Nisma ligjore Qytetare me mbështetjen e UNDP Website: [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)



*jetesës së nevojshme për zhvillimin e fëmijës*<sup>33</sup>. Në pjesën më të madhe të rasteve, fëmija i besohet nënës për rritje dhe edukim, si ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore, ndërsa ati i fëmijës detyrohet të paguajë një detyrim për ushqim, mujor. Nga një monitorim i vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, rezulton se në vitet 2011-2014, mesatarisht, kjo gjykatë, në 87% të rasteve të zgjidhjes së martesës ka vendosur që nëna të ushtrojë drejtpërdrejt përgjegjësinë për rritjen dhe edukimin e fëmijës, ndërsa ati i fëmijës të paguajë detyrimin ushqimor, sipas rastit<sup>34</sup>.

Ndërkohë që në kuadrin e shërbimeve që ofrojmë për këtë çështje në Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, ndërmorëm një iniciativë për të monitoruar situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin për ushqim të fëmijëve, hasëm menjëherë në mungesën e të dhënave statistikore. Në vjetarin statistikor që botohet çdo vit nga Ministria e Drejtësisë, nuk gjendet ndonjë e dhënë dhe nuk mund të arrihen konkluzione për këtë çështje. Nuk arritëm të siguronim ndonjë statistikë, as nga zyrat përmbarimore të rretheve gjyqësore, as nga Dhoma e përmbaruesve privatë. Kërkuam ndonjë listë apo ndonjë bazë të dhënash për debitorët, por nuk kishte asnjë gjurmë. Në situatën kur përmbaruesit privatë veprojnë për të ekzekutuar një pjesë të këtyre vendimeve, vjelja e të dhënave statistikore bëhet më e vështirë. Megjithatë, edhe pse nuk kemi statistika të botuara posaçërisht për këtë çështje nga institucionet e shtetit shqiptar<sup>35</sup>, disa të dhëna zyrtare të tërthorta, si dhe të dhëna të organizatave jofitimprurëse, na bëjnë të besojmë se ka një numër të konsiderueshëm vendimesh gjyqësore që nuk ekzekutohen, ose që ekzekutohen pjesërisht.

Nga të dhënat zyrtare për rastet e gjykuara në procesin penal, për veprën penale “*mosdhënie e mjeteve për jetesë*” (neni 125 i Kodit Penal), rezulton se gjykatat shqiptare kanë gjykuar çështje me këtë objekt dhe, kanë dënuar personat për mosdhënie të mjeteve për jetesë. Nga Vjetari statistikor i përvitshëm i Ministrisë së Drejtësisë, evidentojmë se në të gjithë vendin, për periudhën 2010-2014, janë gjykuar në total 331 çështje penale me këtë objekt dhe janë dënuar 229 persona, të ndarë në vite në tabelën që vijon<sup>36</sup>. Ndërsa, vetëm në vitin

33 Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës, 1989, neni 27/2.

34 Raport “*Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë tiranë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj*”. Cituar.

35 Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, publikon vjetarët Statistikorë që japin dinamikën e gjykimeve në Shqipëri, në procesin penal e civil. Por, nga këta vjetarë është e pamundur të arrihet në konkluzione të posaçme mbi normën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të prindërve ndaj fëmijëve.

36 **Tabela nr.1.** Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë.

Viti	Nr. i Çështjeve të gjykuara me objekt “Mosdhënie e mjeteve për jetesë”	Nr. i personave të dënuar
2010	44	45
2011	41	42
2012	49	43
2013	89	45
2014	108	44

Shih: [http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/Vjetari\\_Statistikor\\_2010.pdf](http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/Vjetari_Statistikor_2010.pdf) [http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/Vjetari\\_Statistikor\\_2011.pdf](http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/Vjetari_Statistikor_2011.pdf),  
[http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI\\_STATISTIKOR\\_2012.pdf](http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_STATISTIKOR_2012.pdf)  
[http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI\\_STATISTIKOR\\_2013.pdf](http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_STATISTIKOR_2013.pdf)

2014 janë gjykuar 108 çështje penale me këtë objekt dhe janë dënuar 44 persona, nga të cilët 28 me burg dhe 16 me gjobë<sup>37</sup>.

Për sa më sipër, këto të dhëna nuk na japin një opinion të qartë lidhur me numrin e rasteve të mosekzekutimit. Kjo, pasi janë të rralla rastet kur mosekzekutimi i këtij vendimi të gjykatës civile, ankimohet penalisht në gjykatë, ose denoncohet si vepër penale. Gjithashtu, në këto statistika nuk janë veçuar rastet e mosekzekutimit të detyrimit ushqimor të prindit ndaj fëmijës, nga rastet e tjera të detyrimeve për ushqim. Sidoqoftë, numri i të dënuarve në vitin 2013 dhe 2014 nuk ndryshon, edhe pse numri i çështjeve është më i madh. Duke analizuar këto të dhëna ne nuk kemi mundësi të nxjerrim konkluzione të qarta në lidhje me efektivitetin dhe performancën e këtij mjeti. Nuk kemi asnjë të dhënë zyrtare se sa ka ndihmuar dënimi me burg ose gjobë, për përmbushjen e këtij detyrimi. Për këtë nevojitet një thellim i studimit statistikor. Sidoqoftë, në rastet që janë përfaqësuar nga QNL, është vënë re se ky dënim ka ndikuar pak, ose aspak në ekzekutimin e vendimeve.

Disa të dhëna alternative ofrohen nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë jofitimprurëse shqiptare, e cila shërben ndihmë ligjore falas për personat në nevojë, në rrethin e Tiranës. Sipas këtyre të dhënave, në periudhën 2014-2015, avokatet e kësaj organizate kanë ndjekur procedurat për ekzekutimin e detyrimit ushqimor për fëmijët, në 87 raste<sup>38</sup>. Nga studimi i këtyre rasteve, rezulton se, 82 nëna janë ngarkuar me vendim nga gjykata e Tiranës të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore duke mbajtur fëmijët e mitur për rritje dhe edukim, në 5 raste fëmijët i janë besuar babait, ndërsa në një rast të vetëm të dy bashkëshortëve. Nga këto, në 86 raste çështja është bërë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm pranë Zyrës shtetërore të Përmbartimit, pasi prindi i ngarkuar me detyrimin për ushqim nuk paguante vullnetarisht. Në një rast të vetëm çështja është çuar për ekzekutim në zyrën e përmbartimit privat. Por, nga këto, vetëm në një rast, ose në 2% prej tyre, është zbatuar vendimi gjyqësor dhe prindi paguan në vijimësi detyrimin për fëmijët. Në 4 prej rasteve vendimi i gjykatës është zbatuar pjesërisht, kurse 96% e rasteve, pra 82 prej tyre, rezultojnë të paekzekutuara asnjëherë. E njëjta situatë na ka rezultuar edhe me detyrimet e prapambetura 2008-2013.

**Konkluzionet e para.** Në këtë pjesë të parë, mund të nxjerrim një konkluzion shumë të rëndësishëm, mbi nevojën e domosdoshme që kemi për përmirësimin e performancës së

37 [http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI\\_2014\\_FINAL.pdf](http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/statistika/VJETARI_2014_FINAL.pdf)

38 Tabela Nr. 2

Viti	Nr. i rasteve të ekzekutuara të ndjekura nga QNL	Nr. i vendimeve që i kanë lënë për rritje dhe edukim nënës, sa babait, sa të dyve.			Sa raste janë bërë objekt ekzekutimi në zyrën e përmbartimit shtetëror / privat 1	Gjendja e ekzekutimit. Sa raste të ekzekutuara vullnetarisht,			
		Nënës	Babait	Të dyve		Numri	Ekzekutuar	Pjesërisht	Vullnetarisht
2014	42	40	2	0	41	1	2	0	39
2015	45	41	3	1	45	0	2	0	43

organeve që ofrojnë të dhëna statistikore mbi këtë çështje. Përgjegjësi të drejtpërdrejtë ka Ministria e Drejtësisë, e cila ka nevojë të përmirësojë bazat e mbledhjes dhe të publikimit të të dhënave. Raporti vjetor statistikor i Ministrisë së Drejtësisë nuk ofron të dhëna specifike mbi numrin e kërkesave në nivel kombëtar për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore. Kështu, nuk marrim asnjë informacion për numrin e vendimeve të ekzekutuara nga përmbaruesit shtetërorë e privatë. Për më tepër, nëse do të ishte e mundur ekzistenca e një liste zyrtare me emra dhe adresat e personave debitorë ndaj detyrimit ushqimor për fëmijët e tyre, ajo mund të përdorej për ekzekutimin e detyrueshëm me masa të tjera alternative, si prioritete në punësim, kontroll kufitar në rastet kur lëvizin jashtë vendit, etj.. Nga ana tjetër, vetë institucionet do të koordinoheshin më mirë për të ndjekur deri në fund çështjen e ekzekutimit të detyrimit për ushqim dhe nuk do të mjaftoheshin vetëm me dënimin me burg ose me gjobë të debitorëve.

## 2. Shkaqet dhe faktorët që shpjen në mosekzekutimin e vendimeve të detyrimeve për ushqim për fëmijët.

Për sa më sipër, nga intervistimi dhe monitorimi i në 82 raste të mosekzekutuara të vendimeve gjyqësore, mund të grupojmë disa shkaqe e faktorë që kanë çuar në mosekzekutimin e tyre.

**Faktorët ekonomikë.** Fakti që në rreth 62% të rasteve, vendimet nuk janë ekzekutuar **për shkak të gjendjes së papunësisë së debitorit** ose për shkak **të punës informale**, na bën të mendojmë se një nga faktorët kryesorë pengues, është pafuqia ekonomike për shkak të papunësisë. Kur flasim për faktorë ekonomikë, ekziston mendimi se nuk mund të presim një zgjidhje të menjëhershme, por një zgjidhje në proces, në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit. Duket sikur kjo frymë buron edhe nga Kushtetuta e Shqipërisë, e cila *punësimin e të gjithë personave të aftë për punë e ka konsideruar një objektiv social* (neni 59.pika 1/a) dhe në të njëjtën kohë ka vendosur: *“Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë”* (neni 59 pika 2). Por, në thelb kjo situatë nuk mund të trajtohet nga institucionet shtetërore si një pritje e gjatë. Ato duhet të ndër marrin masa pozitive, me qëllim që ky *target* grup të ketë mundësi të përmbushë detyrimin. Deri më sot, kjo është kërkuar të zgjidhet vetëm përmes pagesës së ndihmës sociale, e cila është parashikuar në aktet ligjore e nënligjore, në një shumë fare të pamjaftueshme<sup>39</sup>. Nuk ka masa të tjera ekonomike pozitive. Ndërkohë, mund të ishte menduar nga shteti për politika të posaçme punësimi të këtyre personave, me qëllim vjeljen e detyrimit për ushqim për fëmijët, ose politika kompensimi, ku shteti bëhet garant për detyrimin për ushqim ndaj fëmijës, kurse prindi detyrohet ta shlyejë atë në raport me Shtetin, në një periudhë të mëvonshme. Mendojmë se masa të tilla nga shteti duhet të merren edhe në rastet kur prindi i detyruar është duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë.

Faktor tjetër pengues për mospërmbushjen e detyrimit për ushqim është edhe **puna informale** e prindit, i cili nuk paguan sigurime, nuk e kalon pagën përmes sistemit bankar, nuk deklaron të ardhura dhe për rrjedhojë, nuk mund të detyrohet nga organet kompetente që të paguajë

<sup>39</sup> Ligj nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

në mënyrë të detyrueshme pensionin ushqimor. Kjo çështje nuk duhet vlerësuar thjesht si një problem që vjen për shkak të moszhvillimit ekonomik, por edhe për shkak të mosfunksionimit institucional dhe të mosefektivitetit të tyre për zbatimin e legjislacionit. Mosmarrja e masave të nevojshme për reduktimin e informalitetit në ekonomi, bëhet shkak për një proces të parregullt ligjor në ekzekutimin e vendimeve të këtij lloji.

**Emigrimi.** Në dy raste të ndjekura nga Qendra për vitet 2014-2015, kreditori jeton jashtë shtetit si emigrant. Këto raste paraqiten në praktikë si krejt të pashpresa. Ato nuk ekzekutohen për një kohë të gjatë ose, asnjëherë. Kjo duket qartë edhe në rastin R.H., të gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, në të cilin, megjithë proceset e gjata që ka ndjekur nëna e fëmijëve, vendimet gjyqësore nuk ekzekutohen që nga viti 2006<sup>40</sup>. Në fakt, aktet ndërkombëtare sanksionojnë të drejtën e vjeljes së detyrimit për ushqim, edhe kur prindërit janë jashtë shtetit. *“Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme në mënyrë që të sigurojnë marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare për fëmijën, qoftë brenda ose jashtë vendit...”* (Konventa për të drejtat e fëmijës, neni 27/4). Gjithashtu, Shteti Shqiptar ka aderuar në konventa ndërkombëtare, si dhe ka ratifikuar Konventën e Hagës *“Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”* (ligj nr.63/2012). Mbi bazën e kësaj Konvente Shteti Shqiptar mund të ekzekutojë vendimin e një gjykate shqiptare për detyrimin ushqimor, në një shtet tjetër. Megjithatë, mund të themi paraprakisht se mekanizmat garantues institucionalë janë krejt të pafuqishëm. Nga të dhënat zyrtare nuk jemi në gjendje të evidentojmë nëse ka pasur ndonjë rast të vetëm apo jo, kur shteti shqiptar ka ekzekutuar detyrimin ushqimor në bazë të këtyre konventave ndërkombëtare.

**Faktorët institucionalë.** Një faktor i dukshëm pengues për ekzekutimin e vendimit në këto raste, është mosefektiviteti institucional. Kjo dobësi shfaqet qartë, si në rastet kur ish-bashkëshorti është i punësuar ose ka prona, por zyra e përmbarimit shtetëror nuk ekzekuton në kohë vendimin, ashtu edhe në rastin kur ish-bashkëshorti është emigrant. Në këtë kuadër, mendojmë se problemet e zbatimit të vendimeve fillojnë nga mangësitë e vetë zyrës së përmbarimit. Nga monitorimi i kryer, në 10% të rasteve, ka rezultuar se detyrimet për ushqim nuk janë ekzekutuar edhe pse kreditorët nuk paraqesin asnjë pretendim të ligjshëm, por justifikohen se kanë krijuar familje tjetër, se nuk janë të sigurt për atësinë, ose nuk kanë adresë, apo i shmangen qëllimisht paraqitjes përpara përmbaruesit.

Megjithatë, vlen të analizohet edhe **fuqia garantuese e legjislacionit përkatës**, disa aspekte kryesore të të cilit po i analizojmë shkurtimisht.

Në Republikën e Shqipërisë, ekzekutimi i vendimeve të gjykatave për detyrimet ushqimore prindërore për fëmijët, rregullohet nga Kodi i Familjes dhe kodi i Procedurës Civile, të cilat kanë përcaktuar disa garanci. Kodi i Familjes (neni 210) vendos si datë të fillimit të detyrimit për ushqim, datën e ngritjes së padisë. Por, fakti që ky akt nuk vendos që vendimi i Gjykatës për caktimin e detyrimit ushqimor të jetë automatikisht titull ekzekutiv, ka sjellë probleme për ekzekutimin e tij në praktikë. Në radhë të parë, kjo do të thotë se ai duhet të vihet në

40 Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH, Nr. 24, datë 21.4.2014, në [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al)

ekzekutim nga vetë personi i interesuar, pra prindi që mban fëmijën për rritje dhe edukim. Për më tepër, një parashikim tjetër në këtë kod (*neni 211*), vendos se, nëse vënia në ekzekutim e vendimit që përmban detyrimin për ushqim, kryhet pas 6 muajve nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, detyrimet për ushqim janë të kërkueshme për 6 muajt e fundit. Praktika tregon se ky fakt, ka sjellë pjesëzime të mëdha në përmbushjen e detyrimeve, pasi për arsye të ndryshme, prindërit kreditorë e vënë në ekzekutim vendimin me vonesë. Kjo ndodh për shkak se, palët nuk i njohin të drejtat dhe kufizimet e parashikuara në ligj, kurse në mjaft raste, ata hezitojnë të vënë në ekzekutim vendimin, pasi shpresojnë në një ekzekutim vullnetar të ish-bashkëshortit. Kjo situatë ka sjellë si pasojë një numër në rritje të rasteve që e vënë në ekzekutim vendimin tej afateve ligjore. Në këto kushte, duket qartë mangësia që krijohet për shkak të mungesës së **këshillimit ligjor**. Për këtë të fundit, ekziston edhe një institucion i krijuar me ligj, Komisioni i Ndihmës Juridike<sup>41</sup>, i cili nuk ka kontribuar fare në këtë çështje. Ndërkohë, ndihma që ofrohet nga organizatat jofitimprurëse është e pamjaftueshme.

Nga ana tjetër, në mangësitë institucionale përfshijmë edhe vakuumet ligjore ose nënligjore. Kjo vihet re veçanërisht, në mungesën e akteve që duhet të përcaktonin organet dhe detyrat e tyre për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve, sipas detyrimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare. Sikurse përmendëm më sipër, Shteti shqiptar ka ratifikuar konventat e posaçme në këtë fushë<sup>42</sup>, por është e nevojshme që të merren masa më të përshtatshme për zbatimin e tyre. Kështu, mosfunksionimi institucional shfaqet veçanërisht kur prindi që detyrohet të paguajë detyrimin për ushqim për fëmijët është emigrant, ose kur për arsye të ndryshme jeton jashtë Shqipërisë.

Në kuadrin e faktorëve institucionalë, garancitë që ofrohen nga zyrat përmbare janë padyshim një faktor i rëndësishëm. Pa pretenduar se bëjmë një analizë të plotë të aksesit të të interesuarve ndaj tyre, si dhe të punës që ato kryejnë deri në përmbushjen e detyrimit, kemi arsye të themi se ka nevojë për përmirësime të ndjeshme. Kështu p.sh., në 19.1 % të rasteve të analizuara më sipër, për shkak të mosfunksionimit të zyrave përmbare shtetërore, nuk është ekzekutuar vendimi brenda afateve të arsyeshme, edhe pse nuk ka pasur pengesa objektive. Gjithashtu, nga Monitorimi i Zyrës së përmbaremit, Tiranë, për vitin 2014, rezultoi se ndodheshin ende pa ekzekutuar 34 tituj ekzekutivë për detyrimin për ushqim. Shkaqet ishin pothuaj të njëjta me ato që përshkruam më sipër. Madje, evidentuam edhe raste kur debitori nuk gjendej në adresë. Që nga viti 2010, ka filluar punën edhe shërbimi përmbare privat<sup>43</sup>, porse nuk jemi në gjendje të shohim nëse ky shërbim ka sjellë përmirësime në ekzekutimin e vendimeve. Ka nevojë për njohjen e të dhënave statistikore mbi përmbaremin privat, për të cilin nuk mund të arrijmë në konkluzione, për shkak të mungesës së të dhënave, edhe pse ligji për organizimin dhe funksionimin e tyre ka hyrë në fuqi përpara 5 vjetësh.

41 Ligj Nr.10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën Juridike".

42 Konventa mbi juridiksionin, dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji Nr. 9443 / 16.11.2005, si dhe Konventa për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes. Ligji Nr. 63 /31.5.2012

43 Ligj nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbare privat".



### 3. Garancitë juridiksionale.

Roli i gjykatave shfaqet veçanërisht në interpretimin e procesit të rregullt ligjor për ekzekutimin e vendimeve për detyrimin për ushqim. Në një analizë të përgjithshme konstatojmë se ato kanë krijuar praktika të rëndësishme për caktimin e detyrimit ushqimor dhe masën e kontributit të tij. Nga monitorimi i sipërpërmendur mbi vendimet gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, rezulton pozitiv fakti që gjykatat japin vendimin duke u mbështetur në parimin e mbrojtjes së interesit të fëmijëve, si interesi më i lartë. Sidoqoftë, praktikat kanë qenë të ndryshme dhe nuk ka ndonjë unifikim të faktorëve në të cilat duhet të bazohet gjykata për të dhënë masën e detyrimit për ushqim<sup>44</sup>. Kjo mangësi krijon vështirësi sidomos kur kërkohet ndryshimi i masës së detyrimit ushqimor për fëmijët. Gjykata e Lartë e Shqipërisë ka vendosur që çdo ndryshim i masës së pensionit ushqimor për fëmijët, të kryhet nga gjykata e vendit ku banojnë fëmijët, me qëllim që të ketë një shqyrtim më të mirë të kushteve dhe rrethanave ku ata jetojnë<sup>45</sup>. Megjithatë, është e rëndësishme që gjykatat të krijojnë një praktikë ndihmuese për të reduktuar rastet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, gjë që ato e kanë elaboruar sidomos, në çështjet me objekt *kundërshtim i veprimeve përmbarimore*. Këtu ka vend për të ngritur një sërë shqetësimesh, por është më i rëndësishëm fakti që gjyqtarët në dhënien e vendimit, të kenë marrë në konsideratë edhe faktorët ekonomik-socialë, jo vetëm formalë, por edhe informatë, me qëllim që të japin një vendim efektiv dhe të zbatueshëm. Për këtë ata mund të thellohen, duke u shprehur edhe për mënyrën e ekzekutimit të këtij vendimi, me qëllim që të jetë realisht i zbatueshëm.

Në këtë kuadër, një rol parësor ka drejtësia Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në tërësi, e ka qartësuar qëndrimin e saj në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, vendimet e saj në këto çështje kanë patur më tepër karakter deklarativ, se sa karakter efektiv për të ndihmuar procesin. Madje, mund të themi se, në çështjet objekt studimi, nuk ka ende një jurisprudencë gjyqësore për të shmangur rastet e mosekzekutimit të vendimeve për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve, tej një afati të arsyeshëm. Kjo ka ndodhur, jo vetëm për shkak të mungesës së sanksioneve ligjore, por edhe për faktin se në vendim nuk saktësohen siç duhet, përgjegjësitë institucionale. I vetmi vendim ku mund të ndalemi është ai nr.24/2014, që ka për objekt, konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm, të tri vendimeve gjyqësore. Këto vendime të lëshuara nga Gjykatat e Librazhdit dhe Elbasanit përkatësisht në vitet 2001, 2008, dhe 2011, vendosnin detyrimin për ushqim për dy fëmijët e kërkueses. Por, kreditori, babai i

44 Raport "**Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë Tiranë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj**". Periudha janar-dhjetor 2014, realizuar nga i Qendra për Nisma ligjore Qytetare me mbështetjen e UNDP Website: [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)

45 Shih: Vendim i Gjykatës së Lartë të RSh, dt. 12.05.2011, Nr.00-2011-942 i Vendimit (245), i cili thekson: "*Duke mbajtur parasysh frymën e Konventës së Hagës datë 19 Tetor 1996 "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", të Kodit të Familjes dhe dispozitat e K.Pr.Civile, rezulton se parësore është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Kështu duke qenë se fëmija i palëve jeton në SHBA, me nënën e saj, çdo rrethanë që i përket prekjes së interesave të fëmijës duhet të shqyrtohet nga gjykata e vendbanimit të fëmijës, e cila shqyrton kushtet dhe rrethanat ku jeton fëmija, kërkesat për mirëritjen e saj*".

fëmijëve nuk e paguante detyrimin që nga viti 2006 dhe pjesën më të madhe të kohës jetonte jashtë vendit. Prandaj, në këtë rast ndodhemi përpara zbatimit të konventës së Hagës për detyrimet ushqimore (sipërcituar).

Duke lexuar me vëmendje arsyetimin e vendimit, mund të evidentojmë një sërë çështjesh, që lidhen sidomos me përgjegjësitë institucionale për ekzekutimin e këtyre vendimeve, si dhe me çështjen e rëndësishme të shterimit të mjeteve në këtë rast. Le të trajtojmë disa prej tyre, për të arritur në një rezultante të analizës logjike në këtë vendim.

Gjykata Kushtetuese ka evidentuar rolin që kanë institucionet në këtë kuadër, e veçanërisht Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, si autoriteti qendror përgjegjës, por pa iu referuar konkretisht ndonjë baze ligjore që të përcaktojë detyrat konkrete të kësaj Ministrie, si dhe procedurat përkatëse me të cilat ajo operon. Ndoshta, sepse një bazë e tillë, me përjashtim të dispozitave që mund të zbatohen drejtpërdrejt nga Konventa, nuk ekziston.

Gjykata ka çmuar se, kërkesja nuk i ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për përmbushjen e të drejtave të fituara me vendim gjyqësor dhe, për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit brenda një kohe të arsyeshme. Ky konstatim, kundërshtohet nga mendimi i dy gjyqtarëve të pakicës, të cilët kanë theksuar shprehimisht se, *“Nga tërësia e fakteve dhe e rrethanave konstatohet se kërkesja ka ndjekur procedurat përmbartimore për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, i ka kërkuar asistencë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe i është drejtuar gjykatave të juridiksionit penal. Në vështrim të kuadrit ligjor në fuqi kërkesja nuk ka mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Rrjedhimisht, në vlerësimin tonë, nuk rezulton që sjellja e kërkueses të jetë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë”*. Në këtë kuadër duket shumë e çuditshme që gjyqtarët të ndahen në mendimin e tyre për çështje fakti, ndërkohë që si rregull duhet të ndahen për çështje interpretimesh. Mjetet ligjore ose ekzistojnë ose jo, pasi ato duhet të jenë të dukshme dhe efektive. Fakti që gjyqtarët nuk janë të një mendjeje për këtë çështje, tregon se legjislacioni nuk është i qartë në lidhje me mjetet. Konkretisht, gjykata është shprehur në vendim se, *“kërkesja nuk ka shfrytëzuar mjetin juridik të ofruar nga kjo Konventë, me qëllim transmetimin e kërkesës së saj për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek. Sipas kësaj Konvente, kërkesa lidhur me zbatimin e vendimit duhet të depozitohet në Gjykatën e Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, dhe më tej autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të komunikojnë midis tyre, për qëllimet e ndihmës juridike të ndërsjellë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, me anë të organeve të tyre qendrore (d.m.th. nga ana e Republikës Greke me anë të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga ana e Republikës së Shqipërisë me anë të Ministrisë së Drejtësisë). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se mos shterimi i mjetit të kërimit për njohje dhe ekzekutim vendimi pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse, nga ana e kërkueses, ka sjellë vonesa në përmbushjen e të drejtave të fituara në rrugë gjyqësore”*.

Është detyrë e drejtësisë kushtetuese të japë vendim duke mbajtur parasysh përgjegjësitë institucionale në lidhje me të drejtën për të informuar dhe këshilluar qytetarin, me qëllim që të sigurohet akses i tij ndaj mjeteve juridike. Gjykata nuk është thëlluar në faktin se ky objekt

gjykimi nuk ishte ushtruar në ndonjë rast të mëparshëm dhe as ishte rregulluar ligjërisht. Prandaj, edhe vetë Gjykata është kontradiktore në ato që thotë. Nga njëra anë Ajo thekson se Ministria e Drejtësisë nuk mund të investojë drejtpërdrejt nga kërkuesja për nisjen e një procedure për njohje, nga ana tjetër e ngarkon ministrinë me përgjegjësi se nuk e ka orientuar drejt kërkuesen mbi bazën ligjore të përshtatshme<sup>46</sup>. Sidoqoftë, ndoshta edhe për vetë gjykatën ka qenë e vështirë të identifikohet baza ligjore e përshtatshme, sa kohë që nuk bëhet e qartë se çfarë objekti do të kishte një gjykim tjetër. Të shtosh hallkat e gjykimit ndërkohë që kërkuesja ka një vendim themeli të formës së prerë, si dhe një vendim për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duket t'u mëshosh procedurave të gjata joefektive. Procedura të tilla nuk parashikohen as në Kodin e Procedurës Civile dhe as në ndonjë manual që do të ishte detyrë e Ministrisë së Drejtësisë ta hartonte. Drejtësia kushtetuese nuk është drejtësi e zakonshme dhe ka të gjitha mundësitë që t'i japë vendin që meriton të drejtës së qytetarit për informacion dhe detyrimin institucional për ta ofruar këtë në kohën dhe cilësinë e duhur, si dhe në mënyrë të barabartë të aksesueshme për të gjithë qytetarët.

Në të njëjtin vendim Gjykata ka theksuar se *“përmbaruesi gjyqësor, në cilësinë e subjektit procedural në fushën e ekzekutimit, ka kryer të gjitha veprimet procedurale për ekzekutimin e vendimeve, fakt i pretenduar nga kërkuesja se nuk është realizuar”*. Në këtë kuptim, ajo ka çmuar se sjellja e Zyrës Përmbarimore Elbasan nuk ka ndikuar në mosvënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor. Por, nëse janë kryer të gjitha veprimet procedurale nga ana e Zyrës përmbarimore dhe, Ministria e Drejtësisë ka dhënë një përgjigje, nuk është e qartë se cila hallkë ka çaluar në mosekzekutimin e këtij vendimi.

Në përfundim, mund të themi se, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk na ndihmon aspak për të krijuar një standard të ri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor në interes të fëmijës.

**Konkluzione e sugjerime.** Në përfundim të kësaj analize të shkurtër, arrijmë në disa konkluzione e sugjerime, të cila po i paraqesim në vijim:

**Së pari** ka nevojë që institucionet përgjegjëse të shtetit shqiptar të bëjnë një pasqyrë të gjendjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve dhe të publikojnë të dhëna të sakta për situatën e zbatimit të tyre (në vëmendje të veçantë për Ministrinë e Drejtësisë).

**Së dyti** kërkohet një rritje e efektivitetit dhe e kapacitetit profesional të zyrave të përmbarimit, me qëllim ekzekutimin e vendimeve të kësaj kategorie. Është e nevojshme të njihet dhe të monitorohet situata e përmbarimit shtetëror si dhe privat, për këtë çështje.

46 Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH, Nr. 24, datë 21.4.2014, në [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al). *“Gjykata eidenton faktin se ky organ, edhe pse nuk mund të investojë drejtpërdrejt nga kërkuesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim të këtyre konventave, ka pasur të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkuesen mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në këtë rast, si dhe hapat që duhet të ndërmerre për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek”*



**Së treti** ka nevojë të rishikohen dispozitat e Kodit të Familjes dhe të përmirësohen garancitë ligjore për ekzekutimin e vendimeve mbi detyrimet ushqimore, brenda një afati të arsyeshëm dhe në vijimësi. Mendojmë se duhet të hiqen penalitetet për mosparaqitjen e kërkesës në afatin 6-mujor.

**Së katërti** ka nevojë për plotësime në aktet ligjore e nënligjore shqiptare, me qëllim përbushjen e detyrimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare në këtë fushë, (në vëmendje të veçantë të Këshillit të Ministrave). Shteti mund të marrë masa më ambicioze për përbushjen e detyrimeve për fëmijët. Kështu, ka vend të analizohet mundësia për zëvendësimin nga shteti të kreditorit për një periudhë emergjente. Më tej, Shteti mund të kërkojë nga kreditori të gjithë masën e detyrimit që duhet të kishte paguar.

**Së pesti** ka nevojë që institucionet e sipërpërmendura të marrin të gjitha masat për të informuar publikun për shërbimet që ofrojnë dhe të rrisin aksesin e tij në këto shërbime. Ka nevojë për rritjen e efektivitetit të Komisionit të Ndihmës Juridike dhe të institucioneve të tjera shtetërore përgjegjëse për ofrimin e ndihmës ligjore falas për qytetarët në nevojë.

**Së gjashti** ka nevojë të rishikohen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucioneve që ngarkohen me ekzekutimin e vendimeve për detyrimin ushqimor, me qëllim që të kenë mjete efektive në dispozicion për realizimin e ekzekutimit. Hartimi i listës së debitorëve dhe e adresave të tyre, është një masë e domosdoshme paraprake për të ndër-marrë masa pozitive ose detyruese, nga ana e shtetit.

**Së shtati** ka nevojë të krijohen të gjitha mekanizmat e përshtatshme për aksesin qytetar të interesuar ndaj institucioneve përkatëse, me qëllim ekzekutimin e vendimeve për detyrimin ushqimor, kur prindërit që kanë këtë detyrim, ndodhen jashtë territorit të RSh-së. Kjo është detyrë që duhet të mbahet në vëmendje sidomos, nga Ministria e Drejtësisë. Hartimi i listës së debitorëve do të ndihmonte në vjeljen e detyrimit ushqimor, duke kërkuar respektimin e vendimit gjyqësor edhe gjatë kalimit të kufirit.

**Së teti** ka nevojë të rritet roli i gjykatave dhe sidomos i Gjykatës Kushtetuese për të realizuar ekzekutimin vendimeve me këtë objekt. Kjo realizohet jo vetëm përmes përmirësimeve legjislativë që rrisin efektivitetin e gjykimit kushtetues, por sidomos përmes njohjes së jurisprudencave më të mira në këtë fushë.

## 5. Bibliografia:

1. “Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës”, UN, 1989, Ratifikuar nga Kuvendi i RSh më 1992.
2. Konventa mbi juridiksionin, dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji Nr. 9443 / 16.11.2005,
3. Konventa për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes. Ligji Nr. 63 /31.5.2012
4. Ligj nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartësor privat”.
5. Ligj nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
6. Ligj Nr.10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën Juridike”.
7. Vendim i Gjykatës së Lartë të RSh, dt. 12.05.2011, Nr.00-2011-942 i Vendimit (245)
8. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH, nr. 24, 2014
9. Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë
10. Raport “Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë tiranë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj”. Periudha janar-dhjetor 2014, realizuar nga i Qendra për Nisma ligjore Qytetare me mbështetjen e UNDP Website: [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)



# RAPORTI

RAPORT MBI GJETJET KRYESORE NGA MONITORIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS  
SË SHKALLËS SË PARË TIRANË, ME OBJEKT ZGJIDHJEN E MARTESËS DHE  
RREGULLIMIN E PASOJAVE TË SAJ